



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të Studimit

Master i Shkencave në “Arkitekturë” me profile:

**“a. Arkitekt; b. Bio-Arkitekt; c. Arkitekt-Restaurues; ç. Arkitekt-
Inxhinier; d. Arkitekt-Interier**

Univesitetit Metropolitan Tirana

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Gjergj THOMAI

Dr. Elvan DAJKO

Nëntor / 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master i Shkencave (PI) në “Arkitekturë” me profile: “a. Arkitekt; b. Bio-Arkitekt; c. Arkitekt-Restaurues; ç. Arkitekt-Inxhinier; d. Arkitekt-Interier

| | | |
|----|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti “Metropolitan Tirana” |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Shkencave në Arkitekturë me profile: a. Arkitekt; b. Bio-Arkitekt; c. Arkitekt-Restaurues; ç. Arkitekt-Inxhinier; d. Arkitekt-Interier; |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | Urdhër Nr. 15, datë 19.01.2017 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 5 vite akademike |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 300 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 16 PAE / 15 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 69 studentë për 4 (katër) vite akademike |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Metropolitan Tirana” u licencua me Vendim Nr.357, datë 12.05.2010 të Këshillit të Ministrave me statusin e Shkollës Private të Arsimit të Lartë “Universiteti Metropolitan Tirana” (*Aneksi Nr.05, VKM e licencimit të UMT*). Sipas këtij vendimi, UMT organizohet në dy fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave të Aplikuara, dhe Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës. Në zbatim të ligjit nr.80/2015 për arsimin e lartë, UMT me Urdhrin nr. 611, datë 28.09.2018 të ministrit përgjegjës për arsimin ka miratuar Statutin e tij, tashmë me statusin si Universiteti “Metropolitan Tirana” (*Aneksi Nr.01, Statuti i UMT*). Universiteti “Metropolitan Tirana” është akredituar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë (ASCAL) në bashkëpunim me Agjensinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë, me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 45, datë 05.07.2019. Vlefshmëria e akreditimit është deri në 14 Dhjetor 2022. Aktualisht, Universiteti “Metropolitan Tirana” përbëhet nga 3 fakultete dhe secili prej tyre ka në përbërje tre njësi bazë, të organizuara si më poshtë:

Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga:

- Departamenti i Shkencave Administrative;
- Departamenti Financë Bankë;
- Departamenti i Informatikës Ekonomike.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;
- Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike;
- Qendra Kërkimore Shkencore.

Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
- Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës;
- Departamenti i Shkencave të Natyrës.

Programi i integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në Arkitekturë me profilet; Arkitekt, Arkitekt-Inxhinier, Arkitekt-Restaurues, Bio-Arkitekt, Arkitekt-Interieri, është licensuar sipas Urdhrit të MASR Nr. 15, dt.19.01.2017. Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (FIA) është njësi kryesore e cila ofron programin e studimit Master i Shkencave në Arkitekturë. e cila është një nga tre fakultetet e këtij universiteti. Njësia bazë përgjegjëse për organizimin dhe cilësinë e programit është Departamenti Arkitekturës dhe Urbanistikës në bashkëpunim me njësitë të tjera akademike si dhe të strukturave ndihmës akademike. Ky program realizohet me 300 kredite, me formë studimi me kohë të plotë në gjuhën shqipe, me kohëzgjatje 5 vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diploma universitare Master i Shkencave në Arkitekturë sipas profileve përkatëse.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM



Në datën 06.07.2021, Universiteti Metropolitan i Tiranës ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit të integruar të studimit: Master i Shkencave në Arkitekturë me profilet; Arkitekt, Arkitekt-Inxhinier, Arkitekt-Restaurues, Bio-Arkitekt, Arkitekt-Interieri Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti, nëpërmjet shërbimit në AMS. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017” ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UMT, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Dr. Gjergj THOMAI dhe Dr. Elvan DAJKO. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësimin e programit të studimit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit ekspertët përgatitën draft raportin dhe hartuan një gamë pyetjesh të cilat ndihmuan në qartësimin e disa pikave dhe problematikave të këtij raporti.

Gjatë vizitës së kryer në UMT, në datat 13 dhe 14 Shtator 2021, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit Metropolitan Tirana. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.



Universiteti “Metropolitan Tirana”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 01.11.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 26 / 44 Prot, datë 01.11.2021. Universiteti “Metropolitan Tirana”, përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr. 293/1 Prot, datë 05.11.2021, “Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Integruar të Ciklit të Dytë të Studimit “Master i Shkencave” në “Arkitekturë” me profile: Arkitekt; Arkitekt-Inxhinier; Arkitekt-Restaurues; Bio-Arkitekt; Arkitekt-Interieri

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I INTEGRUAR

| Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi Master i Shkencave në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. | |
|--|---|
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi “Master i shkencave” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | <p>Referuar Statutit të UMT, rezulton se është përcaktuar qartë se misioni i universitetit është: <i>Ofrimi i arsimit të lartë dhe veprimtarive krijuese në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e Universitetit. Zhvillimi dhe mbrojtja e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike e kërkimit shkencor. Formimi i studiuesve të rinj në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë nëpërmjet programeve universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohorë teorik, metodik e praktik. Themelimi i kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë duke ofruar mundësi të mira për të përfituar nga arsimit të lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Kontribuimi në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.</i> Referuar planit të zhvillimit strategjik të UMT, rezulton se vizioni i Universitetit Metropolitan Tirana është promovimi i vlerave kombëtare nëpërmjet ofrimit të edukimit/arsimit me qëllim nxitjen e rritjes së etikës qytetare, të profesionalizmit, në ndërtimin e modelit të respektimit të kodeve të sjelljes, me synimin për formimin dhe ndërtimin e qytetarëve model dhe konsolidimin e vlerave dhe interesave kombëtare në fushën e arsimit. <i>(Plani strategjik i zhvillimit të UMT).</i></p> <p>Nga vizita në institucion si dhe nga dokumentacioni mbështetës (DVV) i IAL, u konstatua se Programi Master i Shkencave në "Arkitekturë" me profile që ofron Universiteti Metropolitan Tirana, është hartuar në përputhje me Statutin e Universitetit dhe me Planin strategjik të zhvillimit të tij. Ky program studimi përputhet plotësisht me kornizat ligjore për arsimin e lartë në vend dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare.</p> |



| | |
|---|---|
| <p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> | <p>Referuar dokumentacionit për programin e studimit në DVV, rezulton se programi i integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Arkitekturë me profilet; Arkitekt, Arkitekt-Inxhinier, Arkitekt-Restaurues, Bio-Arkitekt, Arkitekt-Interieri” synon transmetimin e njohurive në shërbim të vendit dhe shoqërisë, synon formimin profesional dhe ate shkencor (bazë) për studentët në fushën e arkitekturës. Që nga fillimi i veprimtarisë së këtij programi (tetor 2018), bazuar dhe ne evidencat statistikore bashkëlidhur RVB si dhe takimeve me stafin dhe studentët, rezulton se është realizuar konsolidimi i programit të studimit, kjo fale kontributit të gjithë aktorëve të përfshirë (staf akademik, staf administrativ, studente etj). Referuar RVB dhe evidencave bashkëlidhur, GVJ gjykon se interesat e zhvillimit të programit të studimit shkojnë në interes të vendit për të patur një produkt i cili konsiderohet i nevojshëm për vendin. Gjithashtu në kontekstin e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e kulturore shërbejnë dhe bashkëpunimet me institucione të arsimit të lartë, organizatat e tjera apo programe ndërkombëtare në fushën e arsimit, në funksion të programeve që ofron ky fakultet.</p> <p><i>RVB programi i integruar MSC ne Arkitekture</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> | <p>Bazuar në dy dokumentet themelore të universitetit Statutit dhe Plani i zhvillimit strategjik të UMT, te Dosja e programit bashkëlidhur RVB, si dhe takimeve në UMT, rezulton se Programi i studimit “Master i Shkencave në Arkitekturë me profilet; Arkitekt, Arkitekt-Inxhinier, Arkitekt-Restaurues, Bio-Arkitekt, Arkitekt-Interieri” është në linjë me qëllimet dhe misionin e institucionit, ashtu siç paraqiten evidencat e sipërcituara.</p> <p><i>Aneksi nr. 01_Statuti i UMT;</i> <i>Aneksi nr. 03_Plani Strategjik i Zhvillimit UMT;</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p> | <p>Referuar dokumentacionit të paraqitur në DVV dhe specifikisht elementëve të programit të studimit, konstatohet se kurrikula është hartuar dhe organizuar për të nxjerrë të diplomuar cilësorë, me aftësi dhe kompetenca të duhura, që i shërbejnë studentit në cdo vend/pozicion ku ai angazhohet.</p> <p>Referuar RVB- së, programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Arkitekturë me profile; synon transmetimin e njohurive të thelluara akademike dhe kompetenca profesionale në shërbim të vendit dhe shoqërisë. Gjatë takimeve me stafin akademik, studentëve të këtij programi, GVJ konstatoi se institucioni ndërmer shumë veprime nxitëse për ti ofruar tregut të punës kuadër të qëndrueshëm. Në RVB citohet se: <i>Ofrimi i këtij programi studimi ka ardhur si kërkesë e tregut të punës për</i></p> |




| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p><i>specialistë arkitektë në profilet; Arkitekt, Arkitekt-Inxhinier, Arkitekt-Restaurues, Bio-Arkitekt, Arkitekt-Interieri, duke marrë në referencë dhe universitete perëndimore lidhur me kurrikulën. Studimet në këtë program master i shkencave synojnë të sigurojnë njohuri të thelluara në fushën e arkitekturës, pasi përmbajtja e programit i pajis studentet me njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si dhe përgatitje për kërkim shkencor të pavarur në këto fusha. GVJ gjykon se programi i studimit në fjalë është hartuar dhe zbatuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të shoqërisë shqiptare.</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor;</p> | <p>GVJ vlerëson se objektivat e programit të integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në Arkitekturë me profile, realizohen plotësisht dhe se studentët janë të përgatitur me njohuri të thelluara teorike si edhe aftësim në përdorimin e metodave dhe instrumenteve kërkimore, përmes një kurrikule të mirëhartuar nga personeli akademik UMT, duke iu mundësuar atyre një bazë të qëndrueshme njohurish, për t’u bërë pjesë e studimeve të ciklit të tretë.</p> <p><i>Aneksi nr. 54 _Plani mësimor</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|--|--|
| <p>Standardi I.2</p> <p>Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p> | |
| Kriteret | Vlerësimi |
| <p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p> | <p>Referuar RVB, statutit të UMT, strategjisë së zhvillimit të UMT, si dhe nga takimet e realizuar në institucion, rezulton se programi i integruar i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në Arkitekturë me profile, është konceptuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit, me misionin dhe objektivat strategjike të tij.</p> <p><i>Aneksi nr. 01 _Statuti i UMT;</i> <i>Aneksi nr. 03 _Plani Strategjik i Zhvillimit UMT;</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i integruar i studimit “Master i</p> | <p>Në Statutin dhe rregulloren e UMT-së gjehen të përcaktuara shtyllat kryesore ku mbështetet gjithë veprimtaria akademike dhe shkencore e institucionit. GVJ konstaton se aktet rregullative të institucionit janë të përditësuar edhe me ndryshimet ligjore të ligjit 80/2015 të arsimit të lartë. Në këto akte rregullatore përcaktohen qartë</p> |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | drejtimet prioritare të institucionit dhe në veçanti ky program studimi ofrohet në përputhje me to. <i>Aneksi nr. 01 Statuti i UMT;</i> <i>Aneksi nr. 02 Rregullore UMT</i> | | | |
| Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Referuar aktit të hapjes të programit të studimit “Master i Shkencave në Arkitekturë me profile, programi zhvillohet me kohëzgjatje normale prej 5 vite akademike, 300 ECTS, në përputhje me nivelin 7 të kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit (KSHK). GVJ, referuar evidencave në dosjen e vetëvlerësimit, konstaton se programi “Master i Shkencave në Arkitekturë me profilet; Arkitekt, Arkitekt-Inxhinier, Arkitekt-Restaurues, Bio-Arkitekt, Arkitekt-Interieri”, i cili ofrohet nga Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës si njësi bazë dhe Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës si njësi kryesore, është në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të UMT dhe specifikisht të Njesisë kryesore dhe asaj bazë. GVJ konfirmon që emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij është në përputhje me fushat dhe orientimet akademike të institucionit. Vlerësojmë se ky program studimi është hartuar dhe implementohet bazuar në objektivat dhe strategjitë e zhvillimit kombëtar të vendit tonë dhe duke u përshtatur brenda mundësive, dhe me zhvillimet aktuale në nivel global. | | | |
| Kriteri 4. Programi i integruar i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |



Standardi I.3

Programi i integruar i studimit synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| Kriteri 1. Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me | Referuar dokumentit (<i>Aneksi nr. 53 Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit</i>), janë të specifikuar qartë objektivat formuese dhe kompetencat profesionale që fiton studenti. Ky program ka si objektiv të sigurojë studentëve njohuri themelore shkencore në fuhsën e arkitekturës si dhe të mundësojë zotërimin e njohurive të thelluara profesionale në disiplina specifike të lidhura me të: inxhinierisë, urbanistikës, bio-arkitekturës, projektimit të interierit si dhe restaurimit. Në përfundim të këtij programi studenti duhet të gëzojë karakteristika profesionale konkrete: |

| | |
|---|--|
| <p>nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p> | <p>Aftësi të mira në projektim; Aftësi të mira në komunikim; Aftësi të mira për punë në grup; Aftësi të mira në vetmësim dhe vetvlerësim; Përditësim i vazhdueshëm i njohurive dhe aftësive kompjuterike në programet si autocad 2D e 3D, Photoshop, 3D Studio Max; Gjithashtu studenti i diplomuar në këtë program studimi do të jetë në gjendje të aplikojë njohuritë me të cilat pajiset edhe në fusha specifike të Arkitekturës si: Arkitekturë Inxhinierike, Bio – Arkitekturë, Arkitekturë Resaturimi e Arkitekturë Interieri. Referuar RVB-së, DVV, takimeve në vend dhe analizës së kryer, GVJ konstaton se programi “Master i Shkencave në Arkitekturë me profile, ka objektiva të qartë në lidhje me formimin dhe përgatitjen e studentëve në fushën e arkitekturës. Këto objektiva bazohen në njohuritë e thelluara teorike dhe praktike që ofrohen, për formimin e profesionistëve të aftë për t’u përballur me oportunitetet dhe sfidat aktuale të këtij profesioni. Njëkohësisht programi i studimit i pajis studentët që e përfundojnë atë me bazën e nevojshme për vazhdimin e formimit të tyre në nivelin e tretë të formimit siç janë doktoraturat. Nga të dhënat në dosjen e vetëvlerësimit, konstatojmë se nëpërmjet këtij programi studimi synohet që studentëve tu jepen njohuri, dije, aftësi dhe kompetenca profesionale në fushën e arkitekturës, në përputhje me nivelin 7 të KSHK.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p> | <p>Në dispozicioni të GVJ është vendosur studimi i tregut të punës përpara hapjes së këtij programi studimi, nga ku ka dalë nevoja dhe kërkesa e tregut për specialistë të këtij profili. (<i>Aneksi nr. 74 Studim tregu per programin</i>)</p> <p>Për këtë program studimi uk ka ende të diplomuar, por Institucioni disponon evidenca të plota mbi punësimin e të diplomuarve për programet e tjera që ofron Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës IT (<i>Aneksi nr. 82 Rrjeti Alumni i UMT</i>). Në takimin me përfaqësuesit e Zyrës së Karrierës, GVJ u njoh me aktivitetin e zyrës për ndjekjen e tregut të punës dhe përdorimin e të dhënave të fituara nga kontaktet me kompanitë apo organizatat që punësojnë të diplomuarit e UMT-së. Përveç komunikimit të formalizuar në dokumenta për interesin reciprok, në këtë zyrë disponoheshin edhe informacionet që merrnin studentët gjatë zhvillimit të praktikave në terren. Referuar RVB dhe takimeve me zyren e karrierës, rezulton se aktiviteti i zyrës së karrierës konkretizohej në statistika lidhur me punësimin ose jo, të diplomuarve të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës. GVJ u njoh me këto rezultate dhe gjykon se janë të kënaqshme për Fakultetin i cili mbulon programin në vlerësim.</p> |

| | |
|---|---|
| <p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të integruar të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> | <p>GVJ pas shqyrtimit të DVV dhe specifikisht dosjes së programit të studimit (<i>Aneksi nr. 53 Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit</i>), konstaton se në përmbajtje, programi MSc. në Arkitekturë, pasqyron të gjitha detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Organizimi i programit të studimit është bërë sipas udhëzimeve përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi. Në bazë të këtyre udhëzimeve lëndët janë ndarë në lëndë bazë, lëndë të formimit karakterizues, lëndë ndërdisiplinore /integruese dhe lëndë plotësuese. Të gjitha lëndët e zhvilluara janë ndërtuar mbi bazën e Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe përmbajnë objektivat e lëndës, rezultatet e pritshme, mënyrën e realizimit dhe të vlerësimit si dhe literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar, të gjitha këto të përfshira në syllabuset e lëndëve respektive. Rishikimi i syllabuseve bëhet me një kërkesë çdo fund viti në departamentin përkatës dhe më pas ato reflektohen në fillim të vitit akademik. GVJ gjykon se në përfundim të studimeve ky program ju mundëson studentëve (të diplomuarve) punësimin si specialistë projektues dhe/ose zbatues në institucione projektuese ose ndërtuese, në sektorin privat dhe publik.</p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p> | <p>GVJ gjykon se programi i studimit në përmbajtje dhe në ndërtimin e tij ka një strukturë të ngjashme me programe të tjera si brenda dhe jashtë vendit. Vlerësimi i lëndëve me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve, ECTS, është në përputhje me Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe lehtëson transferimin e studimeve apo ekuivalentimin e tyre në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit duke krijuar mundësi reale punësimi dhe lehtësim në transferimin e studentëve.</p> |
| <p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p> | <p>Programi i studimit Msc në “Arkitekturë” me profile, është i hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin udhëzues të BE për arsimin e lartë, si dhe në eksperiencën disa vjeçare që ka UMT në ofrimin e programeve të ciklit të dytë. Ky program është i bazuar në sistemin e Bolonjës. Marrëveshjet e bashkëpunimit të Institucionit dëshmojnë për synimin e Universitetit që programet e studimeve, stafi akademik, mobiliteti i studentëve të kontribuojnë në përvetësimin e praktikave më të mira Evropiane.</p> |
| <p>Kriteri 6. Programi i integruar përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e programit të studimit, GVJ gjykon se se programi i studimit përmbledh formimin e përgjithshëm dhe atë profesional në përputhje të plotë me profilin e studimit dhe qëllimin e tij. Studentët kishin mundësinë të realizonin praktika profesionale përgjatë studimeve duke siguruar që pas përfundimit të tyre të jenë të aftë të ushtrorjnë profesionin e fituar në mënyrë të pavarur dhe me profesionalizëm.</p> |






| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Kriteri 7. Në programin e integruar duhet të përfshihen elementë të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p> | <p>Referuar RVB dhe takimeve me stafin akademik dhe studentët rezulton se UMT është një ndër të paktat institucione të arsimit të lartë që ofron programe studimi të licencuara në gjuhë të huaj. Pavarësisht se programi Master i Shkencave në Arkitekturë është i licencuar në gjuhën shqipe, disa lëndë si: Projektim Interieri, Projektim Arkitektonik, Studio VI, ofroheshin dhe në gjuhë të huaj. Lidhur me ndërkombëtarizimin, Institucioni ka realizuar marrëveshje me shumë institucione ndërkombëtare si dhe bashkëpunim në projekte të ndryshme institucionale.</p> | | | |
| <p>Kriteri 8. Për programin e integruar, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p> | <p>Nga takimi me titullarët e FIA-s, rezulton se UMT-ja ruante dhe depozitonte dokumentacionin kryesor të programit edhe në gjuhën angleze. Ai ruhet në formë elektronike dhe "hard copy" duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |


Standardi I.4

Programi i integruar është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë</p> | <p>Referuar RVB, evidencave mbështetëse të tij, takimeve me stafin akademik dhe titullarët e institucionit, rezulton se në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës procesi mësimor realizohej nga personeli akademik efektiv dhe ndihmës akademik, lektorë të huaj dhe personel akademik më kontratë.</p> <p>Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës është një nga Njësitë kryesore që e ka filluar veprimtarinë e vet me hapjen e këtij institucioni në vitin akademik 2010-2011. Referuar <i>(Aneksi nr. 68 Te dhena statistikore te PAE dhe PAK - FIA.)</i>, Fakulteti ka gjithsej 76 pedagogë, nga të cilët 23 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 3 kanë titullin "Profesorë", 3 kanë titullin "Profesorë të Asociuar", 5 kanë gradën Dr., dhe 12 Asistent Lektorë me Msc; dhe 53 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka titullin "Profesor", 3 kanë titullin "Profesorë të Asociuar", 18 kanë gradën Dr. dhe 31 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës ka 8 PAE dhe 15 PAK.</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik, sipas evidencës (<i>Tabela 02_ Stafit akademik i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave i Integruar në Arkitekturë</i>), rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie për vitin akademik 2020-2021 30 pedagogë gjithsej, ku 16 PAE, nga të cilët, 2 Prof.Asoc, 5 me gradën Dr, si edhe 9 asistente-lektore me Msc, dhe 14 PAK nga të cilët 1 Prof.Dr, 7 me gradën Dr/PhD, si edhe 6 asistente-lektore me Msc.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2020-2021 rezulton 53% me 47%, por duke ju referuar dokumentit (<i>Tabela 04_Ngarkesa totale e personelit akademik të programit MSC i integruar në arkitekturë - Viti akademik 2020-2021</i>), rezulton se 73% e programit të studimit mbulohet nga Personel akademik efektiv (PAE), konkretisht 2120 ore në auditor, duke plotësuar kështu kërkesat ligjore në fuqi. Personeli i angazhuar në mësimdhënie, referuar CV të secilit prej tyre, rezulton se kishte një eksperiencë në procesin akademik dhe atë kërkimor shkencor. Ai dispononte një aktivitet shkencor dhe botime të konsiderueshme në revista si brenda dhe jashtë vendit, si dhe pjesëmarrje aktive në konferenca të shumta me karakter shkencor.</p> |
| <p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>Programi i integruar i ciklit të dytë të studimit në Arkitekturë me profile ofrohet nga Departamenti Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, pjesë përbërëse e Universitetit Metropolitan Tirana, dhe GVJ gjykon se programi përputhet tërësisht me fushën akademike të këtij fakulteti dhe të departamentit përgjegjës për programin, të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e Universitetit dhe të Fakultetit.</p> <p>Referuar Dosjes së programit, rezulton se Msc në Arkitekturë është program i integruar i ciklit të dytë të studimit, niveli 7 i Kornizës shqiptare të kualifikimeve, organizuar me 300 kredite evropiane dhe kohëzgjatje normale 5 vite akademike (me kohë të plotë), në përputhje me nenin 70 të Ligjit 80/2105 për arsimin e lartë, i cili ofrohet sipas klasifikimit dhe kodimit të programeve të studimit që parashikohen nga dispozitat ligjore në fuqi.</p> |
| <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p> | |




| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.


| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> | <p>Rferuar organigrames së Universitetit, rezulton se FIA është e organizuar në tre departamente: Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit; Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës; Departamenti i Shkencave të Natyrës të cilat bashkërendonin punën e tyre për të siguruar ecurinë e programit të studimit. Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës (që mbulon programin e studimit në vlerësim), drejtohej nga Përgjegjësi i Departamentit dhe kishte në përbërje 8 personel akademik me kohë të plotë. Nga takimi me stafin akademik, rezulton se në departamente organizoheshin mbledhje me personelin akademik, në të cilat diskutohej mbi problematika të ndryshme në lidhje me procesin mësimor. Këto problematika përcilleshin nëpërmjet koordinatorit të programit në dekanat. Gjithashtu koordinatori i programit përcillte në departament edhe problematikat e studentëve që mund të kishin të bënin me orarin mësimor apo kërkesa të ndryshme. Për të siguruar kontrollin e cilësisë së mësimdhënies koordinatori i programit, verifikonte përputhshmërinë e realizimit të syllabuseve me orët e mësimit pa cënuar lirinë akademike të pedagogut. Nga biseda me personelin akademik, si dhe me përgjegjësin e departamentit, u evidentua se puna e tyre bazohej në 4 shtylla kryesore: mësimdhënia, kërkimi, pjesa administrative dhe puna në komunitet. Gjithashtu, nën koordinimin e departamenteve, ishin realizuar projekte të ndryshme për komunitetin, në të cilin ishin përfshirë dhe studentët.</p> |
| <p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p> | <p>Referuar evidencës së bashkëpunimeve, (<i>Aneksi nr. 28_Lista e shkembimeve nderkombetare te UMT</i>), takimeve me titullarët e FIA-s dhe stafit akademik, rezulton se për të arritur objektivat e përcaktuar në kuadër të procesit mësimor, fakulteti dhe UMT dispononin një sërë bashkëpunimesh me institucione arsimore apo kompani të ndryshme të fushës së arkitekturës dhe të ndërtimit, si</p> |

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të integruar të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p> | <p>dhe me universitete të huaja, nëpërmjet të cilave krijohet mundësia e realizimit të aspekteve të ndryshme të procesit mësimor.</p> <p>Referuar evidencës (<i>Aneksi nr. 27_Lista e universiteteve bashkepunuese ne kuader te shkembimit – mobilitetit</i>), Institucioni dëshmon se ka 19 marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore ndërkombëtare. Institucioni ka të miratur rregulloren e praktikës mësimore nga Senati Akademik (<i>Aneksi nr. 124_Dokumentacioni i praktikës për programin e studimit</i>), e cila përcakton organizimin e praktikës, detyrimet e institucionit dhe praktikantit. Praktika zhvillohet nga ne Institucione të caktuara nga Universiteti. Ndërsa brenda UMT është zyra e karrierës dhe Alumnit, që mbështet studentët për realizimin e praktikave.</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p> | <p>Nga evidencat në dispozicion si dhe nga takimet me titullarët e FIA-s dhe stafin akademik, rezulton se UMT kishte marrëveshje të lidhura në nivel institucional të cilat konsideroheshin të rëndësishëm në ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit, kryesisht në mundësimin e kryerjes së praktikave të studentëve. Nga takimi me stafin akademik rezultoi se në ecurinë e procesit mësimor të këtij programi kishin ndikuar pozitivisht dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me Universitetet ndërkombëtare, nëpërmjet të cilave ishte mundësuar ardhja e personaliteteve akademike në fushën e arkitekturës dhe ndërtimit, profesorë të këtyre universiteteve të cilët kanë lektuar në auditorët e FIA, organizuar workshope dhe kurse trajnimi, si dhe kishin marrë pjesë në konferencat e organizuara nga UMT me leksione plenare. FIA kishte bashkëpunim të qëndrueshëm me Arkivin Qendror Teknik, Bashkinë e Tiranës, studio Projektimi, shoqëri ndërtimi, ekspert të fushës së arkitekturës, nëpërmjet të cilave stafi akademik përditësohej me të reja më të fundit në fushën e arkitekturës, në kuadër të realizimit të programit të studimit.</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p> | <p>Rritja e numrit të bashkëpunimeve të reja, ishte pjesë e strategjisë së zhvillimit të UMT dhe FIA, proces i cili kryhej dhe zhvillohej në mënyrë të vazhdueshme Në nivel universiteti, fakulteti dhe departamenti, çdo vit akademik kryhej analiza e punës dhe rezultatet e bashkëpunimit një pjesë e të cilave janë bërë publike në raportet vjetore të fakultetit dhe universitetit, çdo vit akademik.</p> |
| <p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike, njëسيا përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p> | <p>(<i>Aneksi nr. 27_Lista e universiteteve bashkepunuese ne kuader te shkembimit – mobilitetit</i>);</p> <p>(<i>Aneksi nr. 22_Lista e marreveshjeve te bashkepunimit dhe anetaresimit ne rrjete</i>);</p> <p>(<i>Aneksi nr. 23_Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te FIA</i>)</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | |

Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe studentëve. | Referuar RVB , rezulton se mundësitë financiare për kërkimin shkencor në nivel Fakulteti ishin të kënaqshme sipas konstatimeve të drejtuesve të fakultetit dhe takimit me stafin akademik. Fakulteti mundësonte publikimin e rezultateve të këtij aktiviteti në Buletinin Shkencor të universitet, i cili botohej në mënyrë periodike. Në këto revista mund të publikonin rezultatet e punimeve të tyre edhe studentët. Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës mbështetej financiarisht nga UMT, për aktivitetet shkencore, ku personeli akademik dhe studentët kishin një pjesëmarrje të rëndësishme. <i>(kjo nga takimi me stafin dhe zyrën e financës).</i> |
| Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | Nga RVB,dhe nga takimi me titullarët e FIA-s, organikës së universitetit, rezulton se UMT ka njësi të dedikuar lidhur me kërkimin sic është Metro research, Metrodesign, incubatori, ku personeli akademik përfshirë dhe studentët kryejnë pjesën më të madhe të aktivitetit kërkimor shkencor. Në nivel universiteti, ndiqen thirrjet e AKSHII-it, si dhe organizatave të tjera per aplikime per projekte shkencore dhe koordinohet puna me te gjitha fakultetet per realizimin e fazes se aplikimit dhe realizimit te projektit. <i>(Aneksi nr. 24_Lista e projekteve te aplikuaru nga UMT dhe projektet fituese)</i> |
| Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | Referuar RVB, organikës së universitetit dhe takimeve me titullarët e FIA-s, rezulton se në strukturën drejtuese FIA-s për kërkimin shkencor ka të përcaktuar Zv. Dekanin për kërkimin shkencor. UMT dhe Fakulteti zhvillonte një gamë të madhe aktivitetesh e veprimtarish kërkimi e studimi (referuar evidencave bashkëlidhur RVB dhe takimeve me stafin akademik). Fakulteti publikonte veprimtaritë kërkimore shkencore, si dhe veprimtaritë të tjera në faqen zyrtare universitetit. Referuar rregullores së UMT dhe rregullores e FIA-s, rezulton se FIA kryen analizën e kërkimit në përmbushje të |
| Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore botuese. | |
| Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për | |

ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor

objektivave strategjikë të institucionit, ne mbledhjet ne nivel Departamenti, te cilët dalin me një raport vjetor te kërkimit shkencor dhe ne nivel Dekanati i cili përgatit raportin vjetor te aktiviteteve te përgjithshme te departamenteve. Aktiviteti kërkimor shkencor zhvillohej në nivel institucional dhe atë individual nga personeli akademik. (Aneksi nr. 50_Rregullore e FIA); (Aneksi nr. 02_Rregullore UMT);

Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës dhe njësitë bazë të tij, referuar planit vjetor të FIA, rezultojnë se zhvillojnë veprimtaritë e parashikuara në përputhje me planin e zhvillimit. Referuar RVB, evidencave lidhur me projektet dhe nga takimet me stafin akademik, rezultojnë se ka një rritje të numrit të pedagogëve të FIA-UMT, të përfshirë në projektet që implementohen nga Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projektet, ku pjesa më e madhe jo vetëm përftojnë eksperiencë në shkrim dhe menaxhim/implentim projektsh, por edhe shpërblehen financiarisht për kontributin e dhënë në këto projekte kryesisht në fushën e inovacionit. Referuar Raportit Vjetor të UMT, rezultojnë se personeli akademik bashkëpunon në nivel departamenti për realizimin e aktiviteteve kërkimore e shkencore. Departamenti mbështet në formë të ndryshme personelin akademik, si dhe mbledh të dhënat mbi aktivitetin e kryer nga personeli i njësisë bazë. Në dispozicion të aktivitetit kërkimor, FIA/UMT ka revistën shkencore Metropolitan Tirana Journal of Science Engineering and Architecture (MTJSEA) me Bord Shkencor në të cilat personeli akademik dhe studentët e FIA mund të botojnë artikuj kërkimorë. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët, rezultojnë se studentët të mbikëqyrur nga udhëheqësi, përfshihen në kërkim shkencor gjatë vitit akademik, kryesisht gjatë zhvillimit të punimit të diplomës.

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|--|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | |

ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË

| Standardi II.1 | |
|--|---|
| Programi i integruar i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi. | |
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit Master i Shkencave në Arkitekturë është hapur për herë të parë në bazë të UMAS Nr. 15, datë 19.01.2017. Referuar dosjes së plotë të programit të studimit, rezulton se programi është i hartuar në përputhje me LAL 80/2015 dhe akate nëligjore në fuqi. Në planin mësimor të programit janë përfshirë lëndë/veprimtari formuese (48) të shprehura në kredite (ECTS) dhe orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit, të ndara sipas kategorizimeve të parashikuara, në lëndë të formimit bazë, të formimit kategorizues, lëndë ndërdisiplinore dhe lëndë plotësuese, duke respektuar përqindjet e kërkuara për secilën prej kategorive. <i>(Aneksi nr. 54_Plani mësimor TABELA 9)</i> |
| Kriteri 2. Programi i integruar i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. | Programi i studimit i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, referuar dosjes së programit rezulton se ka informacion të plotë në fushën e arkitekturës. Informacion ky që mundëson pajisjen e studentit me njohuri bazë në fushën e arkitekturës dhe përfitimin e aftësive profesionale në përputhje dhe me nivelin që i përket në KSHK. <i>(Aneksi nr. 54_Plani mësimor TABELA 9)</i> |
| Kriteri 3. Programi i integruar i studimit jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. | Referuar Dosjes së programit të studimit, rregullores se programit, rezulton se programi i studimit ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe praktike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Ai synon pajisjen me njohuritë të thelluara, të menduarin kritik, si dhe ka përmbajtje të tillë që tu ofrojë studentëve njohuritë bazë dhe të avancuara për të ndjekur ciklin e tretë të studimit. Programi i studimit, ofron njohuri jo vetëm në disiplinat e thelluara teorike të integruara me ato profesionale por edhe në ato integruese dhe të fushës së praktikës profesionale me qëllim përgatitjen e profesionistëve të aftë, për të punuar në tregun e punës si dhe për të zgjidhur çështje komplekse dhe inovative në fushat e aplikuara profesionale dhe në fushën kërkimore <i>(Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E).</i> |
| Kriteri 4. Programi i integruar i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | Referuar Dosjes së programit, planit mësimor për vitin akademik 2020-2021, rezulton se programi i studimit është i organizuar në përputhje të plotë me VKM nr.41\2018, lëndët e parashikuara në planin mësimor janë të organizuar sipas kategorive (A-E) me ngarkesën në kredite përkatësisht A, B, C, D, E. Në planin mësimor është paraqitur qartë dhe praktika profesionale me 12 kredite, e cila realizohet në përputhje me rregulloren specifike të zhvillimit të praktikës, gje e cila vlerësohet pozitivisht nga GVJ. | | | |
| Kriteri 6. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Referuar planit mësimor rezulton se janë përcaktuar saktë ngarkesa në kredite për temën e diplomës (18 kredite), e cila zhvillohet në vitin e fundit të studimeve nën udhëheqjen e një pedagogu përgjegjës në përputhje me procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës-MSc Arkitekturë. <i>(Aneksi nr. 59 Modeli i diplomës)</i> | | | |
| Kriteri 7. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuara kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | Referuar organigramës së universitetit, rezulton se njësia kryesore e cila ofron programin e studimit është Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës. Struktura, përbërja dhe funksionimi dhe drejtimi i tij janë të përcaktuara në statutin e Universitetit (UMT) dhe janë në përputhje me detyrimet ligjore të parashikuara. UMT me njësitë e tij kryesore është akredituar si institucion i arsimit të lartë nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë për një periudhë 5 vjecare. Pas riorganizimit UMT është akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 45, datë 05.07.2019, me afat vlefshmërie deri më 14.12.2022. Ndërsa përsa i përket programit të studimit është hera e parë që po kalon procesin e akreditimit. Departamenti Arkitekturës dhe Urbanistikës ka në përbërje 8 pedagog staf akademik të brendshëm, ndërsa stafi ndihmës-akademik dhe ai administrativ është i organizuar në nivel |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | |
|---|--|
| | <p>universiteti. Programi i studimit Master Shkencor në Arkitekturë me profilet; Arkitekt, Arkitekt-Inxhinier, Arkitekt-Restaurues, Bio-Arkitekt, Arkitekt-Interieri ofrohet nga Departamenti Arkitekturës dhe Urbanistikës, pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, UMT përbëhet nga 30 pedagog, nga të cilët 16 pedagog me kohe të plote dhe 14, pedagog staf me kohe të pjesshme ku 14 anëtarë të stafit akademik kanë grada e tituj dhe 3 në proces doktore, duke plotësuar në mënyrë optimale kriteret ligjore dhe standardet për të ofruar programin e studimit. Pjesë e stafit të ftuar theksojmë se janë personalitete të fushës së arkitekturës kryesisht me titull akademik ose me përvojë në fushën e projektimit arkitektonik, të cilët sjellin eksperiencën dhe informacionin që kanë në fushat e tyre specifike.</p> <p><i>(Aneksi Nr.66, Lista e plotë e PA me kohe të plotë e të pjesshme-FIA-Tab.Nr.2); (Tabela Nr. 7 Të dhëna përmbledhëse për stafin akademik për programin e studimit sipas kualifikimit)</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> | <p>Fakulteti i Inxhinierise dhe Arkitekturës në UMT, përbëhet nga tre departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës; 2. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit; 3. Departamenti i Shkencave të Natyrës; |
| <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p> | <p>Departamentet bashkërendojnë punën për realizimin e programit të studimit. Këto departamente janë të ndara sipas disiplinave mësimore të përafërta dhe kanë në përbërjen e tyre një personel akademik me kohë të plotë në përputhje me kërkesat ligjore (≥7 pedagoge me kohe të plote).</p> |
| <p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> | <p>Fakulteti i Inxhinierise dhe Arkitekturës në vitin akademik 2020-2021, ka në përbërje të tij 76 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 23 janë staf akademik efektiv (PAE), dhe 53 staf akademik me kontratë, (PAK).</p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p> | <p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2020-2021 është:</p> <p><u>Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 8 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada; - 15 PAK, ndër të cilët, 7 me tituj / grada; <p><u>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 8 PAE, ndër të cilët 4 me tituj / grada; - 38 PAK, ndër të cilët 12 me tituj / grada; <p><u>Departamenti i Shkencave të Natyrës:</u></p> |

- 7 PAE, ndër të cilët 4 me tituj / grada:
- 0 PAK

Ndërsa kualifikimi i personelit akademik në nivel Fakulteti është:

| Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës | Viti akademik 2020-2021 | |
|---|-------------------------|-----------|
| | PAE | PAK |
| Prof.Dr | 3 | 1 |
| Prof.As | 3 | 3 |
| Dr | 5 | 18 |
| Msc (Dr ne process) | 3 | 2 |
| Msc | 9 | 29 |
| Totali | 23 | 53 |

Stafi akademik i Departamentit të Arkitekturës dhe Urbanistikës që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK, referuar (Tabela 06_Lista e plotë e PA me kohe të plote dhe të pjesshme FIA) është si më poshtë:

Për vitin akademik **2018-2019**, (7 PAE / 15 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 4 / 7;



Për vitin akademik **2019-2020**, (8 PAE/ 18 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 5 / 6;

Për vitin akademik **2020-2021**, (8 PAE / 15 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 3 / 7;

Për sa më sipër Njësia kryesore (FIA) dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:

- numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik;
- organizimin dhe strukturën akademike;

Referuar të dhënave të vitit 2020-2021 në dokumentacionin e paraqitur bashkëlidhur RVB, rezulton se është ruajtur raporti i mbulimit të ngarkesës mësimore midis personelit efektiv dhe atij me kontratë në masën mbi 70% sipas kërkesave ligjore. Duke ju referuar (Tabela 04_Ngarkesa totale e personelit akademik të programit MSC i integruar në arkitekturë - Viti akademik 2020-2021), rezulton se 73% e programit të studimit mbulohet me Personel akademik efektiv, konkretisht 2120 ore






| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | ne auditor, duke plotësuar kështu kërkesat ligjore në fuqi. (Aneks. Tabela nr 12). Për realizimin e programit mësimor fakulteti angazhonte dhe personel ndihmës akademik efektiv (një) që referuar numrit të studentëve në këtë program gjykojmë se është i mjaftueshëm. | | | |
| Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Referuar RVB dhe takimit me stafin akademik, rezulton se një nga stafi akademik i brendshëm kryen rolin e koordinatorit të programit. Në këtë rol, koordinatori përcjell shqetësimet e studentëve në lidhje me realizimin e programit mësimor në përputhje me planin e miratuar, respektimin e orarit të mësimdhënies nga personeli akademik, cilësinë e sallave të leksioneve dhe seminareve, materialet didaktike etj. Koordinatorin informon vazhdimisht drejtuesin e departamentit dhe Fakultetit qoftë nëpërmjet takimeve verbale apo në takime të tjera që realizohen gjatë vitit akademik. Koordinatorin i programit raporton periodikisht në mbledhjet e departamentit raporton në lidhje me ecurinë e programit, aspektet pozitive, problemet sie dhe masat e marra përzgjidhjen e tyre. | | | |
| Kriteri 7. Koordinatorin i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |


Standardi II.3

Programi i integruar i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të integruar të ciklit të dytë.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion gjykojmë se Fakulteti i Inxhinirisë dhe Arkitekturës ka një dosje të plotë të programit mësimor duke përfshirë elementet e nevojshme për përmbushjen e kërkesave ligjore. Fakulteti dhe departamenti kishin të përcaktuar planin mësimor të programit të studimit, objektivat dhe synimet e tij në rregulloren e programit, syllabuset e lëndëve, dhe personelin akademik të nevojshëm. GVJ konstaton se dokumentacioni i ofruar, takimet me studentët dhe pedagogët dëshmojnë për angazhim maksimal të Departamentit për zhvillimin e programit të studimit. Gjithashtu kishte të dhëna të qarta mbi kuotat e pranimeve, tarifat e studimit dhe numrin e studentëve. (Aneksi nr. 53 _Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit) |

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës dhe, të ndara në vite e semestra.</p> | <p>Referuar planit mësimor të programit të studimit, rezulton se programi është i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është zhvilluar në përputhje me programin e licensuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Programi i integruar i studimit Msc në Arkitekturë me profile, me nga 60 kredite për cdo vit akademik plotëson kriteret e organizimit dhe grumbullimit të krediteve brenda kornizës ligjore, e cila parashikon studime me kohë të plotë, dhe prej 300 ECTS.</p> <p><i>(Aneksi nr. 54_Plani mësimor (TABELA 9)</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p> | <p>Referuar planit mësimor programi është i strukturuar në bazë të kërkesave dhe përcaktimeve ligjore. Këto ishin të parashikuara në planin mësimor ku çdo kategori kishte peshën e vet specifike në %: A (18%), lëndëve karakterizuese profesionale B (55%), lëndë ndërdisiplinore dhe integruese C (14 %), lëndë plotësuese aftësimi informatik dhe praktikës profesionale D (7 %) dhe detyrime përmblyëse, mbrojtja e diplomës E (6 %).</p> <p>Sipas rregulloreve të brendshme të IAL dhe bazuar në specifikat e vecanta të programit të studimit elementët e aktiviteteve akademike janë:</p> |
| <p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> | <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 990 orë; - Seminare 800 orë; - Detyrë kursi 260 orë; - Projekt kursi 610 orë; - Praktikë profesionale 160 orë; - Diploma/provimi final 180 orë |
| <p>Kriteri 6. Programi i integruar i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> | <p>Ngarkesa në total e studentëve në auditor 3000 orë</p> <p><i>(Aneksi nr. 55_Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E) (TABELA 9).</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p> | <p>UMT nëpërmjet Vendimit të Senatit me Nr.10 prot, datë 11.02.2019 ka të miratuar kriteret e pranimeve të studentëve për këtë programstudimi konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nota mesatare e shkollës së mesme sipas VKM përkatëse, për të gjitha vitet, përfshirë provimet e maturës të jenë në masën 60 %; - Nota mesatare e gruplëndëve të përcaktuara për cdo program studimi të jetë në masën 40 %; |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>- Njohje e gjuhës së huaj sipas përcaktimeve të udhëzimit përkatës të MASR;</p> <p><i>(Aneksi nr. 33_Kuotat e pranimit për programet e ciklit I, II, dhe të integruar, miratuar me VSA, viti akademik 2019-2020 ~1)</i></p> <p>Programi i studimit disponon syllabuset e të gjitha lëndëve që zhvillohen. Kryesisht ato kanë të dhënat e kërkuara nga dispozitat ligjore në fuqi mbi emërtimin, kategorizimin, kreditet, ndarjen dhe numrin e orëve të Leksioneve, Seminareve, Laboratoreve, Paktikave si dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Përmbajtja e plotë e programit të studimit iu vihej në dispozicion studentëve gjatë javës së parë të fillimit të lëndës. <i>(Aneksi nr. 56_Plan programet e lëndëveve syllabuset)</i></p> <p>Referuar RVB –së rezulton se përditësimi është bërë në syllabuset (ne tema të veçanta të tyre), literaturën e lëndës etj. Dokumentacioni programit disponohet në gjuhën angleze.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| Kriteri 1. Ngarkesa e programit të integruar të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Referuar planit mësimor, orarit mësimor të publikuar, rezulton se ngarkesa mësimore në programin e studimit është shpërndarë në përputhje me VKM nr.41, Dt.24.01.2018, i ndryshuar, duke ruajtur ngarkesën ditore, javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, detyre kursi, projekt kursi, etj. Ora mësimore zgjat 50 minuta, rreth 5 orë mësimore në ditë/25 orë në javë. |
| Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Nga shqyrtimi i dosjes së programit të studimit, rezulton se përmbajtja e programit të studimit siguron formim me bazë të gjërë të studentëve në drejtim të fushës së studimit Arkitekturë, duke ju mundësuar studentëve punësimin e tyre apo si bazë njohurish për vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve. Orët e mësimin në auditor (leksione, seminare, ushtrime, detyra kursi/projekte laboratorë si dhe kontrolli i vazhdueshëm) janë në funksion të interaktivitetit të studentëve me pedagogun e lëndës. |
| Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, | Referuar planit mësimor dhe dosjes së programit në tërësi, rezulton se ndarja e lëndëve ndër vite akademike ishte e tillë që i mundësonte |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | |
|--|--|
| <p>vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p> | <p>studentët të fitonin gradualisht konceptet themelore dhe të arrinin objektivat e programit. Gjithshtu shpërndarja e veprimtarive formuese në leksione, seminare, laboratorë apo praktika ishte bërë në mënyrë optimale për të arritur rezultatet e dëshiruara, duke nxitur studentët të krijojnë në mënyrë të pavarur, të praktikohen më shumë në detyrat e kursit/projekte që zhvillojnë. (Aneksi nr. 54_Plani mësimor TABELA 9).</p> |
| <p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të integruar “Master i shkencave” dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> | <p>Referuar dosjes së programit, rezulton se kurrikula e programit të integruar Msc në “Arkitekturë” është e ngjashme për nga përmbajtja me kurrikula të tjera kombëtare apo ndërkombëtare. Emërtimi apo raportet teori/praktikë janë në përputhje me profilin e programit pa anashkaluar dipozitat ligjore përcaktuese.</p> <p>Në syllabuset e lëndëve ishin të përcaktuara qartë ndarja mes orëve të formimit teorik, laboratorik dhe praktikës. Gjithashtu ato përcaktonin edhe objektivat e synuar të formimit për secilën lëndë. Gjykojmë se arritja e këtyre objektivave krijon kushte për transferim të studimeve apo mobilitet sikurse edhe punësim.</p> |
| <p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> | <p>(Aneksi nr. 54_Plani mësimor TABELA 9).</p> |
| <p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> | <p>Syllabuset e programit të studimit, nga verifikimi përkatës rezultojnë se përmbajnë të gjitha elementet sipas VKM nr. 41, Dt.24.01.2018, i ndryshuar. Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë të detyrueshme dhe literature ndihmëse. Përditësimi i përmbajtjes së syllabuseve koordinohet nga drejtuesit e departamenteve të cilët njëkohësisht monitorojnë realizimin e lëndës/modulit në përputhje me syllabusin e miratuar. (referuar RVB dhe takimeve me stafin akademik). Nga shqyrtimi i DVV dhe Dosjes se Programit, rezulton se literatura është e përditësuar sipas kërkesave të standardeve së cilësisë.</p> |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të integruar të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë.</p> | <p>Bazuar në RVB, ne dosjen e programit të studimit, si dhe ne takimet e realizuara në institucion, GVJ gjykon se përmbajtja e programit të integruar të studimit “Msc në Arkitekturë” garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> <p>Ky program studimi mundëson përgatitjen e individëve të aftë për t’u thelluar më tej në studime të avancuara të ciklit të tretë apo për tu punësuar në tregun e punës të fushës.</p> |
| <p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të integruar të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> | <p>FIA kishte një numër të konsiderueshëm bashkëpunimesh (lista e bashkëpunimeve) dhe partnerësh, të cilët ndihmonin në një lloj orientimi drejt nevojës së tregut. Nga ana tjetër, fakti që vetë pedagogët janë dhe ushtrues të këtij profesioni bën që të kuptojnë</p> |

| | | | | |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të integruar të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p> | <p>nga afër kushtet e zhvillimit të tij në vendin tonë dhe të kuptojnë prioritetet se drejt ku duhet shkuar.</p> | | | |
| <p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor mundëson njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p> | <p>Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor dhe kohëzgjatja e programit prej 5 vitesh, mundëson njohuri të avancuara. Referuar RVB dhe dosjes së programit të studimit (planit mësimor), rezulton se kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor krijon mundësinë e përfundimit të njohurive më të avancuara, duke iu mundësuar atyre aftësitë e domosdoshme për të zhvilluar punime shkencore, si një hap i parë drejt kërkimit të mirëfilltë shkencor.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

| Kriteret | Vlerësimi | | | | | | | |
|--|--|-----|-----------|-----|-----------|-----|-----------|-----|
| <p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi.</p> | <p>Stafi akademik dhe administrativ i programit të studimit është i përzgjedhur për të përmbushur objektivat e programit. Ngarkesa mësimore e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit MSc. në Arkitekturë, rezulton se është në përputhje me kërkesat ligjore dhe aktet rregullative të UMT.</p> | | | | | | | |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të integruar të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> | <p>Nga shqyrtimi i (<i>Evidenca plotësuese për akreditimin e programit të integruar të studimit në arkitekturë me profile</i>), kërkuar gjatë vizitës në institucion numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi në 4 vitet akademike që është aktiv është:</p> | | | | | | | |
| | 2017-2018 | | 2018-2019 | | 2019-2020 | | 2020-2021 | |
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| | Prof.Dr | 1 | - | 2 | - | 1 | - | 1 |
| | Prof.Assoc | 1 | - | 2 | - | 2 | 2 | - |
| | Dr | 3 | 5 | 5 | 6 | 7 | 5 | 7 |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | | | | | | | | |
|--------------|----|----|----|----|----|----|----|----|
| MSc | 2 | 3 | 5 | 4 | 5 | 5 | 9 | 7 |
| | 6 | 19 | 12 | 12 | 14 | 11 | 16 | 15 |
| Total | 15 | | 24 | | 25 | | 31 | |

Për sa i përket mbulimit të programit me staf akademik efektiv (%) për katër vitet është :

2017-2018 – 40 % PAE;

2018-2019 - 50 % PAE;

2019-2020 – 56 % PAE;

2020-2021 – 52 % PAE;

Sic është referuar më lart, mbi 70% e ngarkesës mësimore mbulohej për personel akademik të brendshëm.

Për sa i përket kualifikimeve të PA:

- **Për 2017-2018**, 66% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 34% janë Msc;
- **Për 2018-2019**, 63% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 37% janë Msc;
- **Për 2019-2020**, 60% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 40% janë Msc;
- **Për 2020-2021**, 48% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 52% janë Msc;

Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezultoti se fusha akademike e personelit të angazhuar ishte në përputhje me lëndët/modulet specifike që ata mbulonin në kuadër të programit të studimit

I gjithë stafi mësimor i përfshirë në mësimdhënie përbëhet nga pedagogë fusha e kërkimit akademik dhe shkencor e të cilëve është ajo e mësimdhënies. fushat e interesit dhe kërkimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, përputhen tërësisht me natyrën e moduleve që ata mbulojnë në këtë program studimi.

Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqytjen e studentëve në praktikën

Referuar *listës së marrëveshjeve me institucione për zhvillimin e praktikës mësimore, si dhe rregullores së zhvillimit të praktikave*, rezulton se për ndjekjen e punimeve të diplomave ishte i angazhuar nga ana e UMT personeli akademik efektiv i fakultetit, i cili synonte realizimin e temave kryesisht praktike apo eksperimentale, duke shfrytëzuar ambjentet dhe kapacitetet e sipërpërmendura. Personeli instruktor, përfaqësues i kompanive ku kryhet praktika profesionale, përzgjidhet me eksperiencë në shkencave

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | inxhinierike. | | | |
| Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit | Nga të dhënat e RVB si dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion mund të thuhet se Fakulteti ka angazhuar personel ndihmës-mësimorshkencor në përputhje me numrin e laboratorëve dhe sasinë e orëve mësimore që zhvillohen në to. Ky personel mbështet realizimin e orëve laboratorike si dhe mirëmban laboratorët dhe mjediset e tjera mësimore. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Fakulteti, sikurse kemi përmendur edhe më lart, kishte një bashkëpunim dhe partneritet të gjerë me institucione të ndryshme, ku një nga qëllimet e këtyre bashkëpunimeve ishte dhe mbledhja e informacioneve në lidhje me kërkesat e tregut të punës. Këto informacione vinin përmes zërit të pedagogëve (të cilët njëkohësisht mund të konsiderohen si treg pune) apo bashkëpunëtorëve dhe diskutoheshin në departamente. Më pas, nëse kishte propozime konkrete për ndryshime në planin mësimor, këto përcilleshin për miratim drejt organeve drejtuese të fakultetit siç është Dekanati, dhe nëpërmjet zyrës së kurrikulave bëheshin subjekt i vendimmarrjes në Senatën Akademik. Nga takimet me studentët rezultoi se atyre iu merret mendimi nëpërmjet anketimeve, takimeve të drejtpërdrejta të realizuara nga koordinatori/përgjegjësi i departamentit apo dhe Dekani i FIA, të cilat konsiderohen nga UMT-ja, si opinione në kuadër të përmirësimit të përmbajtjes së lëndëve/ moduleve apo ngarkesës në kredite/orë apo raportet e veprimtarive formuese. |
| Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. | |
| Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre | Sipas drejtuesve të institucionit, ky i fundit ruan kontaktet me studentët e diplomuar. Një pjesë e tyre marrin pjesë edhe në aktivitetet shkencore që organizon fakulteti, sikundër eksperiencat |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| propozime për përmirësimin e programit të studimit. | e tyre profesionale ose akademike brenda ose jashtë vendit i ndajnë me institucionin me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Në këtë program studimi nuk ka ende të diplomuar. | | | |
| Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi. | Bashkëpunimi me institucione kërkimore e shkencore, referuar listës së marrëveshjeve dhe listës së projekteve të aplikuara dhe të fituara nga UMT, rezulton se është pjesë integrale e aktivitetit kërkimor shkencor dhe në këtë kuadër propozimet e tyre dhe përmirësimi i programeve diskutohen vazhdimisht. Marrëveshjet e bashkëpunimit dhe aktivitetet e vazhdueshme të organizuara së bashku, krijojnë lehtësira dhe mbështetje për përditësimin, përfundimin dhe përmirësimin e procesit të mësimdhënies, trajnimit dhe kërkimit, duke ofruar kurse që janë plotësisht në përputhje me politikat e formimit të të rinjve dhe e arsimit të vazhdueshëm në vend dhe në rajon. Nga RVB dhe dosja e vetëvlerësimit, rezulton se bashkëpunimi me Shoqatën e Arkitektëve dhe Urbanistëve të Shqipërisë ka qene i vazhdueshëm. Studentet kane marrë pjesë në aktivitete te organizuara nga kjo shoqatë. | | | |
| Kriteri 5. Në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private, institucioni përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|--|---|
| Standardi II.7 | |
| Programi i integruari studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. | |
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | Përmbajtja e programit të studimit me lëndët dhe syllabuset qartësojnë prioritetet dhe objektivat e studimit. Ato janë me përmbajtje të thelluar shkencore, që si produkt i programit të studimit do të krijohen profesionist të cilëve ju jepet mundësia për vazhdim të studimeve të mëtejshme në ciklin e tretë si dhe mundësi e zhvillimit të veprimtarive profesionale në tregun e punës. Objektivat e programit të studimit përputhen me objektivat e institucionit. |
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | Departamenti menaxhon programin e studimit, gjithashtu kujdeset për stafin akademik për ngarkesën e tyre në mësimdhënie si dhe në punët administrative të Institucionit. Stafit mund të zhvillojë kërkim shkencor në mënyrë të pa penguar. |
| Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon | |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | Nga takimi me stafin akademik dhe studentët rezulton se me orientimin e stafit akademik, studentët angazhohen dhe marrin pjesë në punime, projekte, aktivitete të karakterit studimor dhe kërkimor shkencor. Referuar dokumentit lidhur me aktivizimin e studentëve në punime shkencore të pedagogëve, rezulton se studentëve të cilat kanë arritje të vlerësuara, iu mundësohet përfshirja në fushën e kërkimit. | | | |
| Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare. | Preferuar RVB, takimeve me stafin akademik, rezulton se UMT-ja mbështet stafin e tij për realizimin e aktiviteteve kërkimore e studimore, nëpërmjet financimeve direkte; nëpërmjet financimeve alternative, projekteve dhe donacioneve, si dhe në kuadër të mobilitetit në universitete të huaja. | | | |
| Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë, nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | Refruar RVB, statutit të UMT, rregullores dhe planit të zhvillimit strategjik të institucionit dhe programit të studimit, rezulton se FIA koordinon punën e vet në funksion të realizimit me sukses të veprimtarisë mësimore e shkencore .Në këtë kuadër, orientimi i thelluar drejt kërkimit shkencor mbështetet edhe nga partneriteti dhe bashkëpunimi që fakulteti dhe UMT ka siguruar dhe siguron në vite. Nga takimi me stafin akademik, u pohua që FIA është angazhuar për t'iu përgjigjur nevojave që ka programi i studimit në kuadër të zhvillimeve të reja në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës, bazuar kjo në bashkëpunimet me kompaninë e ndërtimit dhe studiot e projektimit etj, bëjnë të mundur njohjen me të rejat më të fundit që aplikohen në këto fusha edhe në vendin tonë nëpërmjet këtyre kompanive. |
| Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | GVJ konstaton se IAL mbështet departamentet dhe Fakultetin, përmes financimit vjetor të projekteve kërkimore. Nga informacioni lidhur me projektet e aplikuara dhe të fituara, rezulton se FIA është partner në realizimin e disa projekteve të cilat kanë impakt në zhvillimin e praktikave të thelluara profesionale dhe në pjesëmarrjen e studentëve në kërkim shkencor. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p> | <p>Referuar RVB-se, zyra e projekteve kërkimore në bashkëpunim edhe me stafin akademik të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, ka aplikuar në projekte kërkimore shkencore, kryesisht në programet e Bashkimit Evropian (Erasmus + KA2, Horizon2020, COSME, COST Action, CEI, etj), thirrje të ambasadave të huaja në Shqipëri (amerikane, angleze, suedeze, ceke, etj), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), GIZ, si dhe institucione shtetërore. Aktivitetet në nivel institucional apo në nivel fakulteti, kanë dhënë një ndihmesë në realizimin e programeve të studimit përfshirë dhe MSc. Referuar të dhënave për kërkimin shkencor, rezulton se FIA ka realizuar evente kërkimore shkencore, konferenca dhe aktivitete, të cilat kanë patur impakt të rëndësishëm tek personeli dhe studentët për arritjen e objektivave, por gjithsesi,</p> <p><i>GVJ rekomandon shtimin e numrit të projekteve në funksion të zhvillimit të kerkimit shkencor, sipas planeve aktuale të institucionit.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |


| | | | | |
|---|------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| | |
|---|--|
| <p>Standardi III.1</p> | |
| <p>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p> | <p>Bazuar në takimin me stafin akademik, rregulloren e programit të studimit rezultoi se institucioni përdor një sërë metodash mësimdhënëse ku përveç metodës tradicionale të mësimdhënies një rëndësi të vecantë i kushtohet studiove/projekteve, praktikave profesionale, përdorimit të teknologjisë së fundit etj. Gjithashtu, GVJ, bazuar në udhëzimin mbi mesimdhënien në distancë në UMT, në takimin me stafin dhe me studentët, ku këta të fundit pajiseshin me laptop që në momentin e regjistrimit, konstaton se ky institucion</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>kishte mundësuar në kohë reale zhvillimin e procesit mësimor online ne kushtet e pandemisë.</p> <p><i>(Rregullore e Programit te Studimit, Udhezim mbi mesidhenien ne distancë, Ndërfaqe classroom e një pedagogu, Platformat per mesimin online, printscreen te perdorimit te edu4school)</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p> | <p>Në UMT, monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës-akademik realizohet në mënyrë periodike nga NJSBC në nivel institucional ndërsa në nivel fakulteti, ky proces monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga njësitë bazë dhe nga Dekanati. Nga takimet që GVJ zhvilloi me NJSBC rezultoi se kjo njësi realizon në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e programit të studimit me anë të pyetësorëve me studentët. Këto pyetësorë realizohen dy herë në vit (ne fund të cdo semstri) ku ata shprehen mbi cilësinë e mësimdhënies, si dhe duke kontrolluar cdo fund viti realizimin e planit vjetor të pedagogëve etj. Edhe në takimet me studentët u evidentua një fakt i tillë. Fakulteti përmirëson në mënyrë të vazhdueshme metodat e mësimdhënies duke respektuar dhe lirinë akademike. <i>(Rregullorja e NJSBC, programi i studimit; metodat e mësimdhënies)</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p> | <p>Nga takimi i GVJ me studentët e këtij programi studimi rezultoi se nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë anë të pyetësorëve që realizoheshin dy herë në vit, studentëve iu mundësohej të jepnin mendimin/vlerësimin e tyre lidhur me cilësinë e mësimdhënies. Instrument tjetër ishte dhe qeveria studentore ku studentët diskutojnë problematikat e tyre lidhur me këtë program studimi duke i adresuar në Fakultet nëpërmjet përfaqësuesit të tyre.përfshirja e përfaqësuesit studentor në mbledhjet e dekanatit dhe komunikimi i vazhdueshëm me koordinatoren e programit mundëson gjithashtu përfshirjen e studneve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies e të vlerësimit të dijeve. Ankimimi dhe rishikimi i vlerësimit janë të garantuara dhe specifikuar ne rregulloret përkatëse.</p> <p><i>(Rregullore e UMT, Rregullore e FIA, Rregullore e programit te studimit, Rregullore e provimeve)</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> | <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) ishte struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimit të cilësisë. NJSBC kryen përpunimin e pyetesoreve të studentëve, të formularëve të performancës të lektorëve, harton raporte dhe analiza bazuar në rezultatet e vlerësimit të programit të studimit, të cilat i përcillen Rektorit të universitetit dhe Senatit akademik. U konstatua se këto rezultatet bëheshin publike nga NJSBC.</p> |





| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| | <p>Nga dokumenetacioni i vënë në dispozicion, takimet me përgjegjësin e departamentit, dekanin e fakultetit, stafin akademik, janë vetë departamentet që monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe veprimtaritë e tjera të stafit akademik dhe atij ndihmës akademik. Gjatë gjithë vitit akademik kryhej procesi i monitorimit të zhvillimit të procesit mësimor, testimeve/provimeve; korrektësia në mësimdhënie etj. Drejtuesi i Fakultetit dhe përgjegjësi i departamentit nëpërmjet kordinatorit të programit ose dhe sekretarisë mësimore, ndjekin në mënyre të vazhdueshme respektimin e orarit mësimor dhe zhvillimin e programit të lëndëve në përputhje me programin e studimit të miratuar. Në takimin me stafin akademik, GVJ evidentoi se raportimi në departament dhe nga departamentet në dekanat mbi zhvillimin dhe ecurinë e procesit mësimor bëhej në mënyre periodike nga ana e tyre.</p> <p><i>(Raporte vjetore, organigrama e UMTsë, Rregullore e NJSBC, Vlerësime të performances të lektorëve shenime të takimeve)</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p> | <p>Nga takimi i stafit akademik të programit me GVJ, rezulton se FIA nxit stafin akademik për hulumtimin e metodave innovative të mësimdhënies në fushën e arkitekturës dhe të ndërtimit duke i mundësuar pjesëmarrjen në kongrese, konferenca apo workshop-e të ndryshme, si dhe exchange në kuadër të programit ERASMUS +.</p> <p>Në kuadër të mësimdhënies, GVJ konstaton se FIA dhe UMT evidenton shembuj të praktikave të mira duke i mbështetur dhe promovuar dhe nga ana financiare (nga takimi me stafin akademik) në respekt të punës dhe përkushtimit të tyre.</p> <p><i>(Lista e Shkëmbimeve Ndërkombëtare të UMT; lista e eventeve të organizuara nga UMT/FIA)</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

Standardi III.2


Institucioni i arsimit të lartë garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat</p> | <p>Referuar Dosjes se Vetëvlerësimit, rezulton se përmbajtja e programit të studimit është e plotë në dokumentacion, përmban informacione të detajuara në lidhje me organizimin e programit të studimit. Referuar syllabuseve të lëndëve, GVJ konstaton se stafi akademik zhvillon lëndët në bazë të leksioneve, seminarëve, orëve</p> |

| | |
|---|---|
| <p>profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p> | <p>të studiove, projekteve detyra kursi, praktika profesionale si dhe provimeve përkatëse të lëndës. Nga dokumentacioni për programin, takimet me stafin akademik si dhe me studentët e programit, rezulton se metodat e transferimit të njohurive të studentëve janë të ndryshme ne varësi të specifikës së lëndës/veprimtarisë formuese, ne respekt të lirisë të veprimit që ka stafi akademik për zbatimin e metodave mësimdhënëse të reja.</p> <p>Është evidente ndërthurja e teorisë me anën praktike në lëndët e formimit bazë dhe specifik të profilit të arkitektit.</p> <p><i>(Rregullore UMT, Rregullore e FLA; Dosja e programit; Syllabuset e programit)</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p> | <p>Nga shqyrtimi i CV- të stafit akademik, takimi me stafin akademik dhe me studentët që realizoi GVJ, rezulton se personeli akademik i programit të integruar të studimit Msc ne Arkitekturë me profile, është i përgatitur dhe ka kualifikimet e duhura për ti ofruar në mënyrë të diversifikuar dije studentëve në lidhje specifikat ne fushën e arkitekturës, duke ndërthurur formimin teorike me atë praktik. Në kuadër të përmirësimit të orës së mësim, GVJ u informua gjatë takimit me studentët se ata përfshihen nga stafi akademik. UMT dhe specifikisht Fakulteti, disponon infrastrukturë cilësore në funksion të realizimit të procesit mësimor. Godina në dispozicion të procesit mësimor është ndërtim i ri, i pajisur mjetet e nevojshme didaktike e laboratorike. Sallat kryesore janë pajisura me sistem audio-vizive (projektorë) ndërsa sallat për formimin praktik janë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e studiove, projekteve.</p> <p><i>(CV-të e stafit, Te dhëna për infrastrukturën)</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p> | <p>Referuar DVV dhe specifikisht CV, rezulton se stafi akademik ka një eksperiencë të konsiderueshme në mësimdhënie. Në vijimësi FIA dhe UMT nxit stafin akademik të marrë pjese në aktivitete (konferenca, workshope, leksione të hapura nga pedagogë të huaj të ftuar etj) apo dhe kanë organizuar workshope lidhur me didaktika të reja te zhvillimit te procesit të mësim, aktivitete këto të cilat u shërbejnë për të përmirësuar kompetencat e tyre didaktike <i>(takimi i GVJ me stafin akademik).</i></p> <p>Format dhe metodat e mësimdhënies të programit përfshijnë leksionet, seminarët, punët laboratorike, studio, detyrat dhe projektet e kursit, praktikën profesionale në përputhje me parashikimet e VKM nr. 41/2018 i ndryshuar. Referuar metodave të mësimdhënies dhe mësim nxënies, GVJ vlerëson se nëpërmjet tyre realizohet pajisja e studentëve me njohuritë dhe aftësitë e duhura për tu përballur më pas mbarimit të studimeve me tregun e</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>punës. (CV e stafit akademik; Lista e aktiviteteve të zhvilluara në UMT/FIA; programi i studimit; syllabuset e lëndëve; shënimet e takimeve)</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p> | <p>Referuar CV-ve të stafit akademik të programit rezulton se stafi është në përputhje me fushën e mësimdhënies. Karakteristikë e stafit akademik të programit është dhe koha e gjatë në mësimdhënie, si dhe background i tyre profesional në praktikën kombëtare dhe ndërkombëtare. Bazuar në këto cilësi GVJ evidenton se stafi akademik i programit të studimit ka kompetencat dhe aftësitë e duhura për të ofruar dhe transmetuar tek studentët dijet e nevojshme në kuadër të fushës së studimit.</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> | <p>Nga takimi me stafin akademik, rezulton se ai është gjithmonë i hapur drejt aplikimit të formave, mënyrave, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe veprimtarive formuese akademike në veçanti. FIA ne vijimësi ndërthur stafin akademik me eksperiencë shumëvjeçare me stafin e ri akademik, duke mundësuar vijueshmëri dhe qëndrueshme të traditës, njëkohësisht dhe implementimin e metodave të reja të mësimdhënies. NJSBC nëpërmjet pyetësorëve semestrale me studentët për procesin e mësimdhënies evidenton sugjerimet për të përmirësuar mësimdhënien, të cilat merren në konsiderate. Po në kuadër të mbështetjes së stafit të ri akademik, NJSBC analizon në fund të vitit akademik formularin e vlerësimit të performances të stafit akademik mbi realizimin e pritshmërive. Format e kontrollit të dijeve bazohen në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin përfundimtar të lëndës: testimet e ndërmjetme, vlerësimi i praktikave laboratorike, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të ndryshme, provimi përfundimtar, mbrojtja e temave të diplomave.</p> <p>Nga takimi që GVJ realizoi me stafin akademik, rezulton se ata përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies duke e integruar teorinë me rastet praktike, projektet e kursit, detyrat e kursit etj. Të gjitha format dhe metodat të mësimdhënies të parashikuara në programin e studimit zbatohen në funksion të përgatitjes së studentit me aftësitë profesionale. Si personeli akademik edhe strukturat përgjegjëse, janë të angazhuar maksimalisht që studenti në përfundim të studimeve të tij të dëshmojë se zotëron këto njohuri, aftësi dhe kompetenca dhe të jetë profesionist i vërtetë në fushën e vet.</p> <p><i>(Takimi me NJSBC; pyetësoret e studenteve; formulari i pedagogëve, takimet me studentet dhe me stafin akademik, plani mesimor, programi I studimit)</i></p> |

| | | | | |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p> | <p>Bazuar në takimin me titullarët e institucionit dhe personelin akademik rezulton se thelbi i procesit mësimor në këtë program është bërë që të vendoset në qender studentit. Kjo realizohej nëpërmjet zhvillimit të orëve interaktive, të cilat ndërthurin shpjegimet në nivel teorik dhe empirik, duke u përqendruar në bashkëveprime të vazhdueshme midis profesorit dhe studentit. Nga takimi me studentët rezulton se stafi akademik nxit debatet mbi rastet e studimit, projektet/detyrat e kursit. Nëpërmjet punës në grup dhe prezantimit të punimeve garantohej dhe ndërveprimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në mënyrë aktive në procesin mësimor.</p> | | | |
| <p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> | <p>Referuar programit të studimit të integruar Master në Arkitekture me profile, rezulton se studentët zhvillojnë në sasi kohe të konsiderueshme në laboratore, me detyra apo projekte kurse, si dhe praktike profesionale.</p> <p>Stafi akademik nxit studentët për të qënë të pavarur, në mbikqyrjen e tyre (kjo nga takime me studentet), si dhe është hapur për aplikimin e formave, mënyrave, metodave alternative të mësimit dhe mësimit në përputhje me programin e studimit. Instrument tjetër i inkurajimit të autonomisë së studentit ishte dhe zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta me studentë dhe pedagogë të institucioneve të tjera, çka kultivon dhe nxit studentët të jenë mendjehapur e të diskutojnë çështje të ndryshme në këndvështrime të reja.</p> <p><i>(metodat inovative në procesin e mësimit, lista e aktiviteteve të zhvilluara nga FIA)</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësimit dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p> | <p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se FIA ka në dispozicion të programit të studimit për realizimin e mësimit 2 godina në Qytetin Studenti. Në to ndodheshin 17 salla seminari (≥40 vende), 8 salla leksioni (≥100 vende), 4 laboratore dhe 2 laboratore ku u krijohej mundësia studentëve të</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




| | |
|---|--|
| | <p>zhvillonin mësimin në situatë reale. Në godinat që disponoheshin, kishte ambiente të kënaqshme dhe të përshatshme (zyra) për stafin akademik, zyra për titullaret e njesive baze dhe kryesore, ambiente zyrash për stafin administrativ dhe ndihmës akademik, zyra për sekretarinë mësimore, sallë leximi dhe biblioteka.</p> <p><i>(Asete infrastrukurore akademike _UMT, Vizita në ambientet e institucionit)</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p> | <p>Referuar vizites së kryer në ambientet e FIA, GVJ konstaton se ambientet e dedikuara për procesin mësimor në Godinat 1 dhe 2, janë funksionale me hapësira të mjaftueshme për studentët dhe stafin akademik për të zhvilluar veprimtaritë mësimore. Auditorët janë të pajisur me PC, video projektor dhe internet.</p> <p><i>(Mjediset e Fakultetit, Njësive bazë FIA-UMT, Infrastruktura e UMT, Vizita e GVJ në ambientet e FIA)</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p> | <p>Bazuar vizites në vend, RVB Kriteri 3, standardi III.3, si dhe takimeve me stafin dhe me studentet, rezulton se FIA _UMT përdor sistem menaxhimi të të dhënave të studentëve. Ky sistem është implemtuar që nga viti 2012, përditësuar në vitin akademik 2020-2021 (platforma edu4school).</p> <p>Në FIA _UMT në të gjitha godinat që kishte në dispozicion, kishte wi-fi, që i shërbente stafit akademik për punën kërkimore shkencore dhe studentëve për realizimin e projekteve apo detyrave të kursit. Për studentët dhe stafin akademik ishte në dispozicion biblioteka e Universitetit, të cilët kanë akses në libraritë online apo në literaturën hard copy që gjendej në bibliotekë.</p> <p><i>(Raporti i Vetëvlerësimit, takimi me stafin akademik dhe me studentët, vizita e GVJ në ambientet e institucionit, Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve)</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p> | <p>Referuar syllabuseve, rezulton se literatura është e viteve të fundit, e cila përditësohet vazhdimisht. Literatura për programin e studimit është kryesisht në gjuhën shqipe, si dhe në gjuhën Angleze kur ajo rekomandohet nga pedagogët. Vetë GVB ka afirmuar në RVB (kriteri 4, Standardi III.3) së është e nevojshme pasurimi në vijimësi të fondit të librave në bibliotekë, gjë e cila u konfirmua nga GVJ dhe gjatë takimeve me stafin akademik.</p> <p><i>GVJ rekomandon shtimin e titujve të literaturës në hard copy për programin e studimit.</i></p> <p><i>Relacion për bibliotekën _UMT-FIA</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në</p> | <p>Referuar RVB rezulton se në bibliotekën e UMT-se ka rreth 758 tituj librash si dhe një sërë njësisish të tjera bibliotekare në vit, ndërkohë që numri i frekuentuesve është relativisht i mirë (në kohe</p> |

| | |
|---|---|
| <p>drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p> | <p>jo pandemie) përsa i përket përdoruesve në sallën e leximit me fonde të hapura dhe të mbyllur. Salla është komode dhe është në shërbim të plotë të përdoruesve si për pedagogë, ashtu edhe për studentë dhe studjuesve të tjerë nga ora 9.00 deri në orën 21.00.</p> <p>Mjediset e bibliotekës, nga vizita që GVJ realizoi në ambientet e institucionit, rezulton se janë të mjaftueshme dhe të mirëpajisura. Studentët deklaruan se në kohë normale janë frekuentues të rregullt të bibliotekës, por aktualisht për shkak dhe të situatës së shkaktuar nga pandemia, ata përdorin bibliotekën në mënyrë të kufizuar ndërkohë që ishte rritur përdorimi nga ana e tyre e librarive elektronike. <i>(Relacion biblioteken-hard copy & elektronike dhe laboratore Informatike _UMT-FIA, Takimi me studentët)</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p> | <p>Nga RVB dhe takimi me studentët rezulton se UMT iu mundëson aksesin në libraritë online personelit akademik dhe studentëve. Gjatë vizitës në ambientet e institucionit, GVJ konstaton se Biblioteka është e pajisur me PC, duke iu mundësuar studentëve gjetjen e burimeve të tjera online. Nga takimi me stafin akademik, rezulton se tjetër mundësi për literaturë bashkëkohore ishin dhe libraritë online të partnerëve me të cilët FIA kishte lidhur marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>(RVB, vizita në ambientet e UMT, takimi me studentet, takimi me stafin akademik)</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p> | <p>FIA për realizimin e punëve laboratorike, detyrave të kursit apo projekteve kishte në funksion labororet informatike të UMT dhe dy laboratorë specifik për profilin e arkitekturës. Ndërkohë nga takimi me studentet u evidentua që secili student ishte i pajisur nga UMT me laptop, ku ishin të instaluar programe në funksion të degës së arkitekturës, që në momentin e regjistrimit të tij në këtë institucion. Biblioteka, si dhe labororët e informatikës, të pajisura PC me programet e nevojshme, shfrytëzoheshin lirisht nga studentët për shkrimin e detyrave të kursit apo diplomave.</p> <p><i>(Ambjentet për Infrastrukturën FIA-UMT, vizita në abjentet e institucionit, takimi me studentët)</i></p> |
| <p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p> | <p>Bazuar në RVB dhe në takimin me stafin akademik rezulton se FIA përdor platformën online GoToMeeting për procesin mësimor. Në kushtet e pandemisë rezulton se UMT ishte nga të parat universitete që nëpërmjet platformës online zhvilloi procesin mësimor. Vlerësojmë pozitivisht synimin e UMT, që dhe në kushte normale, kombinimin e metodës klasike të mësimdhënies në auditor me atë online.</p> <p><i>(Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Takimi me titullarin e FIA, takimi me stafin akademik dhe me studentët)</i></p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




| | | | | |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët, shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p> | <p>Shpërndarja e informacionit, materialet lidhur me leksionet, detyrat projektet etj, komunikimi i ndërsjelle pedagog/student, ruajtja e të dhënave, menaxhimi i projekteve apo grupeve të punës, kryhej nëpërmjet sistemit edu4shools. UMT përdor platformën “GoToMeeting-GTM” për procesin e mësimdhënies. Platformat në dispozicion të stafit dhe të studentëve aksesoheshin prej tyre nëpërmjet adresave personale të e-mailit me domeinin e institucionit (emër.mbiemer@umt.edu.al).</p> <p><i>(Raporti i Vleresimit të brendshëm, Takimi me stafin akademik, takimi me studentët, Udhëzuesit per platformat elektronike)</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p> | <p>Bazuar në LAL/2015, në Statutin dhe rregulloren e UMT, si dhe në rregulloren e programit, studenti i programit të integruar Master i Shkencave në Arkitekture ka të drejtë të shlyejë detyrimet finale me temë diplome. Për realizimin e temës së diplomës, Institucioni kishte të miratuar procedurën që ndiqet për realizimin e punimit të temës së diplomës dhe mbrojtjes së saj.</p> <p><i>(Aneksi nr. 64 _Rregullorja e Diplomes)</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| | |
|--|--|
| <p>Standardi III.4</p> <p>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> | <p>Në përputhje me kërkesat ligjore të LAL 80/2015, UMT-ja ka të ngritur me Vendim të Senatit Akademik, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila ka për detyrë sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësimin e veprimtarisë kërkimore shkencore si dhe monitorimin e funksionimit të njësive administrative. NJSBC përgatit në nivel institucional raporte periodike të cilat iu vihen në dispozicion Rektorit të universitetit dhe Senatit Akademik.</p> <p><i>(Rregullore e NJSBC, Vendimi i Senatit per ngritjen e NJSBC, Takime te GVJ me NJSBC, titullarët e FIA dhe me stafin akademik,, Raporte analitike vjetore)</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe</p> | <p>Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës dhe Departamenti Arkitekturës dhe Urbanistikës janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë të programin e studimit. Nga takimi me NJSBC rezulton se janë kryer takime, konsultime të planifikuara me Dekanin,</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




| | |
|---|--|
| <p>studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p> | <p>zv/dekanin dhe përgjegjësit e departamenteve ku është diskutuar mbi ecurinë e programit të studimit, me problematikat e evidentuara nga pyetësorët me studentët apo stafi akademik, duke adresuar, përcaktuar detyrat me afatet e tyre, si dhe gjetur zgjidhje me qëllim përmirësimin dhe garantimin e zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p><i>(Statuti dhe Rregullorja e UMT, Rregullore e FIA, Rregullore e NJSBC, takimi me NJSBC, takimi me stafin drejtues të FIA, takimi me stafin akademik të programit)</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> | <p>Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UMT, rezulton se FIA dhe Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës janë përgjegjës për programin e studimit të integruar Master i Shkencave në Arkitekturë. Fakulteti dhe Universitet mbështesin stafin akademik në veprimtarinë e tyre kërkimore shkencore, gjë e cila bën që personeli akademik të zhvillojë e përvetësojë metoda të reja në mësimdhënie. Një instrument tjetër është dhe organizimi i aktiviteteve të dedikuara për zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies, kjo bazuar dhe nga deklaratimet në takimet me stafin akademik dhe titullarët e institucionit, për përmbushjen e një prej objektivave strategjike të UMT, ai i të qëniti novator në këtë aspekt.</p> <p><i>(Takimi me titullar të e FIA, takimi me stafin akademik, Plani i zhvillimit strategjik të UMT, Listat e aktiviteteve të zhvilluara)</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> | <p>UMT motivon kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik për trajnime të ndryshme në fushën e mësimdhënies, dhe për kërkimin shkencor. UMT ka mundur kualifikim të mëtejshëm të personelit si nëpërmjet kërkimeve dhe studimeve brenda vendit ashtu edhe nëpërmjet kërkimeve jashtë vendit. Rezulton nga takimi me stafin akademik se ata janë mbështetur nëpërmjet studimeve të ndryshme afat shkurtër ose afat gjatë, si dhe programeve të mobilitetit të pedagogëve, në kuadër të marrëveshjeve që ka lidhur UMT me institucione të arsimit të larta, organizata të ndryshme ndërkombëtare si dhe të programeve ndërkombëtare si Erasmus +.</p> |
| <p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p> | <p>Bazuar në evidencat ku jepet lista e aktiviteteve të kryera dhe lista e shkëmbimeve të stafit akademik në kuadër të programit Erasmus, si dhe në takimin që GVJ realizoi me dekanin dhe stafin akademik, rezulton se programi i integruar i studimit Msc në Arkitekturë ofrohet dhe në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet departamenteve (Dep të inxhinierisë së Ndërtimit) dhe si i tillë stafi akademik në nivel fakulteti përfiton përvoja në fusha të cilat kanë ndërthurje midis tyre. FIA dhe UMT ka organizuar konferenca, workshope, orë të hapura ku stafi akademik ka patur mundësinë e përmirësimit të njohurive dhe aftësimin me metoda të reja mësimdhënëse.</p> <p><i>(Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete, Lista e projekteve të aplikuara nga UMT dhe projektet fituese, Lista e</i></p> |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>universiteteve bashkëpunuese në kuader të shkëmbimit/mobilitetit dhe trajnime ku stafi ka marrë pjesë)</i> | | | |
| Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur ne DVV, nga takimi me stafin akademik dhe me studentet, rezulton se stafi akademik angazhohet vazhdimisht në punë kërkimore dhe merr pjesë në trajnime kualifikuese të cilat përpos rritjes së kualifikimit individual të tyre, përmirësojnë dhe metodat e mësimdhënies për lëndët që ata mbulojnë, duke sjelle dhe shembuj të praktikës me të mirë. Profesorët në përbërje të stafit të angazhuar janë personalitete të fushës së arkitekturës dhe të ndërtimit, dhe njëkohësisht me eksperiencë në institucione të huaja të arsimit të lartë, konstatim ky nga takimi me stafin akademik, me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit. Në vlerësimin tonë si GVJ, kjo eksperiencë bën që ky staf përveç se është zbatues të metodave të reja inovative, por dhe janë shembuj të praktikave më të mira në funksion të përmirësimit të cilësisë. Në këtë këndvështrim GVJ e konsideron pikë të fortë cilësinë e personelit akademik dhe profilin e lartë akademik që ata kanë. <i>(Aneksi nr. 61 CV Personeli Akademik FIA)</i> | | | |
| Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | Nga dokumentacioni ne dispozicion, nga takimi me stafin rezulton se në fund të çdo viti akademik secili pedagog plotëson arritjet akademike dhe kërkimore shkencore, ku jepen dhe të analizuar dhe metodat e reja të mësimdhënies. Kjo evidencë i vihat në dispozicion fakultetit, i cili analizon ne tërësi këtë aspekt sipas programeve të studimit që ofron. <i>(Raportet vjetore, formulari i performaces)</i> | | | |
| Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor | Referuar evidencave bashkëlidhur RVB si lista e lektorëve të ftuar, si dhe takimit me stafin akademik dhe studentët, rezulton së FIA fton lektorë vendas dhe të huaj të cilët me përvojën e tyre japin kontribut në përmirësimin e programit të studimit. Dhe praktika e shkëmbimit të lektorëve në kuadër të programit Erasmus, është instrument tjetër që UMT përdor dhe në funksion të përmirësimit të programit, ku përfshihen shkëmbimi I ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në fushën e Arkitekturës dhe ndërtimtarisë. <i>(Lista e institucioneve me të cilat FIA-UMT ka marrëveshje, lista se lektoreve te ftuar, lista e aktiviteteve te zhvilluara ne FIA, UMT, Lista e personelit akademik qe ka kryer mobilitete ne kuader te programit Erasmus)</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|--|--|--|--|---|
| | | | | X |
|--|--|--|--|---|

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kriteret, mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale të marra, janë të mirëpërcaktuara në aktet rregullatore të institucionit. Në takimin me studentët, rezulton se ata njiheshin rregullisht me përmbajtjen e lendeve, që në fillim të viti akademik. Mënyra e vlerësimit të studentit realizohet gjatë gjithë zhvillimit të lëndës, duke u vlerësuar për angazhimin e tij gjatë zhvillimit të lëndës dhe në rezultatin final të provimit të lëndës. Referuar syllabuseve të lëndëve, takimit me stafin dhe takimit me studentët, rezulton se format e testimit të njohurive janë për aktivizime në seminare, praktika, dorëzim projektesh, detyrash, testime të pjesshme dhe provimi final. <i>(Aneksi nr. 56 ___Plan programet e lëndëveve syllabuset)</i> |
| Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Referuar takimeve me stafin akademik dhe me studentët, rezulton se që në fillim të zhvillimit të lëndës, studentët njihen nga pedagogu me syllabusin e lëndës, ku janë të përcaktuar format e vlerësimit të njohurive dhe metodat e mësimdhënies. Ndërkohë një kopje e syllabusit i vihej në dispozicion studentit nëpërmjet platformës edu4school. Nëpërmjet syllabusit të lëndës, studentet pohuan se informohen me metodologjinë e testimit, vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës. <i>(takimi me studentët dhe me stafin akademik)</i> |
| Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara | Sipas rregullores se provimeve dhe në syllabuset e lëndëve, si dhe në pohimet e studentëve gjatë takimit me ta, rezulton se testimi i njohurive dijeve dhe aftësive të fituara nga studentët gjatë vitit akademik realizohet duke vlerësuar pjesëmarrjen dhe aktivizimin e tij në seminare, detyrat e kursit, (ese, projekte etj), labororet, testimet e ndërmjetme, praktikën profesionale dhe temën së diplomës. Provimi përfundimtar i lëndës zhvillohet me gojë ose me shkrim, në varësi të specifikave të lëndës, sipas përcaktimeve në syllabus.. <i>(Aneksi nr. 56 ___Plan programet e lëndëveve syllabuset).</i> |




| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. | Referuar rregullores se programit të studimit, rregullores se provimeve rezulton se vlerësimi i studentëve për çdo lëndë/veprimtari formuese realizohet gjatë gjithë vitit akademik, si dhe në vlerësimin përfundimtar. Në syllabuse është përcaktuar qartë dhe vlerësimi për angazhimin e studentit në seminare apo në realizimin e detyrave apo projekteve, që pohuar dhe nga studentët, reflektohen në vlerësimin final të lëndës. <i>(Aneksi nr. 56_Plan programet e lëndësve syllabuset).</i> |
| Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | UMT kishte në funksion sistemin e menaxhimit të institucionit edu4school. Nëpërmjet këtij sistemi, rezulton se ruhet konfidencialiteti, rritet shpejtësia e kontrollit të provimeve të ndërmjetme etj. GVJ gjykon se angazhimi i institucionit për promovimin dhe përdorimin e metodave elektronike në testimin e rezultateve të të nxënit, sjell rritjen e transparencës në vlerësimin e studentëve, si dhe minimizon forma të ndryshme të abuzivizmit në vlerësim. |
| Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | Vlerësimi përfundimtar realizohet nga komisionet e provimeve (jo më pak se 2 pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës) të ngritura nga departamentet dhe të miratuara nga Dekani i Fakultetit, siç parashikohet nga Rregullorja e përgjithshme e UMT-së, Rregullorja e provimeve dhe Udhëzimi i Dekanit të FIA. <i>(Aneksi nr. 120_Rregullore e provimeve – UMT)</i> |
| Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie. | Mjediset ku zhvillohen provimet janë të monitoruara me kamera (konfirmuar gjatë vizitës së GVJ në ambjentet e UMT) dhe me personel ndihmës akademik që ka si detyrë kryesore ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë për zhvillimin normal të procesit të provimeve. Provimet realizohen me sekretim kur ato zhvillohen me shkrim. Referuar RVB dhe takimeve me studentët, rezulton se komisionet e provimeve sigurojnë transparencë, nuk lejojnë kopjimin apo forma të tjera që deformojnë vlerësimin. Gjithashtu, për të siguruar kontrollin e provimeve me objektivitet, UMT përdorte dhe metodën e Clean Score (leximi automatik të rezultateve të tezës me alternativa). Rezultatet paraprake iu njoftohen studentëve në formë të personalizuar, nëpërmjet platformës edu4school. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | |
|---|--|
| | <i>(RVB, Udhëzimi i UMT mbi Procedurat për zhvillimin e provimeve)</i> |
| Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente /feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Bazuar në RVB, në takimin me studentët, GVJ konfirmon se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit, shoqërohet me feedback nga pedagogu përkatës, kjo realizohet dhe nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me studentin, pa cënuar integritetin e tij. Pedagogu i lëndës këshillon dhe orienton studentët në fillim të semestrit, në rastin kur ata kanë pjesë të lëndës detyra kursi apo projekte kursi, se si duhet të strukturohet një punë e tillë. <i>(Takimi me stafin, takimi me studentët)</i> |
| Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikqyrjes dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiature gjatë procesit të provimit. Referuar DVV rezulton se në UMT funksionon Këshilli i Etikës i cili ka dhe rregulloren dhe e vet. <i>(Aneksi nr. 14_Rregullore e Etikes UMT)</i> |
| Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Referuar RVB dhe takimeve me stafin dhe me studentët, rezulton se rezultatet paraprake të provimeve ju bëhen të njohura studentëve nga komisioni i provimit nëpërmjet platformës, në formë të personalizuar (për provimet më shkrim). Ndërsa për provimet me gojë, direkt pas përfundimit të provimit. GVJ konfirmon se rezultatet e provimeve jepen sipas përcaktimeve të afateve kohore referuar rregullores së provimeve. |
| Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Bazuar në rregulloren e provimit dhe Udhëzimin mbi procedurat për zhvillimin e provimeve UMT-së, si dhe në takimin me studentët, rezulton se studentët pasi njihen me vlerësimin paraprak përfundimtar të marrë në provimin e lëndës, ushtrojnë të drejtën e ankimimit në lidhje me vlerësimin sipas afateve të përcaktuara në dokumentat e sipërcituar. Komisioni i provimit është i detyruar të shqyrtojë dhe sqarojë studentin lidhur me rezultatin e provimit, bazuar në përgjigjet e dokumentuara në fletë provimin e plotësuar të studentit. Studenti nëse ka përsëri pakënaqësi lidhur me notën, dhe pas procedurës së mësipërme, ka të drejtë të kërkojë komision tjetër për vlerësimin e tezës. Procedurat e ndjekura për ankimimet e studentëve për vlerësimin përfundimtar të lëndës, dokumentohen dhe arkivohen pranë sekretarisë mësimore (nje kopje) dhe arkives së UMT. |
| Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet | Në takimin me studentët u pohan raste të ankimimit të komisionet e vlerësimit të lëndës apo të adresimit të këtyre ankesave dhe në departament dhe fakultet, nga ana e tyre ose përfaqësuesit të studentëve të fakultetit. <i>(Aneksi nr. 63_Rregullore e provimeve)</i> |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | x |

| Standardi III.7 | |
|---|--|
| Programi i integruar i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët. | |
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Në rregulloren e programit të studimit, është specifikuar misioni i programit të studimit i cili është: të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe profesionale në fushën e arkitekturës. Organizimi i kurrikulës së e programit të studimit Msc në Arkitekturë në lëndë të formimit bazë dhe atë profesional (48 lëndë përfshirë praktikën profesionale dhe temën e diplomës), u garanton studentëve aftësim dhe rritje profesionale në mënyre progresive <i>(Aneksi nr. 54_Plani mësimor)</i> |
| Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Referuar dokumentacionit të programit të studimit të paraqitur dhe specifikisht Planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve rezulton se programi i studimit u mundëson studentëve pajisjen me dije në fushën e teknologjisë së informacionit veçanërisht në lëndën SAP 2000, e me dije mbi fushën humane e sociale në lëndët, sociologji urbane si dhe me njohuri mbi gjuhën e huaj në lëndën, anglisht. <i>(Aneksi nr. 54_Plani mësimor)</i> |
| Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. | Nga takimi me stafin dhe studentët, si dhe bazuar në DVV, rezulton se studentët testohen mbi njohuritë e përfituara në çdo lëndë, në përfundim të çdo semestri. Syllabuset e lëndëve me objektivat e tyre përkatës rishikohen cdo fillim viti akademik nëpërmjet një procesi të zyrtarizuar të institucionit. Kjo bën që ato të jenë të përditësuara me të rejtat e fundit mbi shkencën e arkitekturës dhe të ndërtimit. <i>(Aneksi nr. 56_Plan programet e lëndëve syllabuset)</i> |
| Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, stafi akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar. | Referuar takimit me stafin akademik, GVJ konstaton se në javët e fundit, pedagogët e lëndës informojnë studentet mbi kompetencat e fituara që duhet të demonstrojnë në provim. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final. |
| Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe | Referuar evidencave lidhur me pedagogët e ftuar vendas dhe të huaj, rezulton se personeli akademik i programit të integruar studimit Msc arkitekturë, realizon periodikisht gjatë vitit akademik orë leksioni |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | dhe seminare të hapura mbi të rejat e fundit të teknologjisë dhe shkencës. | | | |
| Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikave profesionale. | Referuar të dhënave mbi infrastrukturën e UMT, vizitës të GVJ në institucion, listës së marrëveshjeve që FIA ka të lidhura për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, rezulton se fakulteti dhe institucionet me të cilat ka marrëveshje ofrojnë tek studentët të gjithë infrastrukturën e nevojshme përfshirë dhe bazen materiale përkatëse për realizimin e studiove dhe praktikave profesionale. GVJ evidentoi nga takimet dhe vizita në vend, qasjen e fakultetit realizimin e procesit mësimor dhe të praktikave profesionale si dhe në krijimin e mundësive për studentët, si një nga pikat pozitive të programit. | | | |
| Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. | Nga takimi me stafin akademik dhe bazuar në RVB, konfirmojmë se stafi nxit studentët për punën në grup me anë të detyrave të kursit, prezantimeve që studentët realizojnë në konferenca të ndryshme me fokus kërkimor shkencor, dhe specifikisht dhe anë të projekteve. | | | |
| Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet. | Personeli akademik me kohë të plotë integron të rejat më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit që ju jepet studentëve gjatë orarit normal të zhvillimit të modulit dhe jashtë tij | | | |
| Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Nga takimet dhe referuar RVB, konstatojmë se Departamenti Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe FIA mundëson një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore në bashkëpunim me studentët. Në shumë raste stafi akademik publikon, referon apo prezanton bashkë me studentët rezultatet e kërkimeve në aktivitete shkencore. Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjeve me IAL të tjera iu është krijuar mundësia e mbështetjes konkrete për kërkimin shkencor. Kjo u konfirmua dhe nga takimi me studentët. Studentët shprehen të kënaqur dhe të motivuar për të marrë pjesë në programë mobiliteti ku disa prej tyre janë mbështetur edhe me bursa 3-6 mujore. | | | |
| Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve | (Mobiliteti studentëve; Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të shkëmbimit/mobilitetit) | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> | <p>Referuar Statutit dhe rregullores se UMT, Rregullores se FIA-s, rregullores së mbrojtjes se punimit të diplomes, rezulton se institucioni ka procedura te qarta që duhet të ndjekin studentët gjatë përgatitjes se punimit të diplomës dhe mbrojtjes së saj. Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës ka të miratuar rregulloren specifike të diplomimit ku janë të përcaktuara procedurat, formatet dhe modalitetet e mbrojtjes së diplomës. Rregullorja e FIA shpjegon të gjithë procesin e diplomimit të studentëve të cilët janë pjesë e IAL. FIA ka rregulloren e veçantë me të cilën përcaktohen procedurat e diplomimit, format dhe modalitetet e mbrojtjes etj. (Aneksi nr. 64_Rregullorja e Diplomes)</p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> | <p>Bazuar në RVB dhe takimet ne insitucion rezulton se departamenti është përgjegjës për njohjen e studentëve me paketen udhëzuese të procedurave dhe afateve kohore, të udhëzimeve mbi strukturen si dhe rregullave të ndryshme për procesin e mbrojtjes së diplomës, dokumenta keto qe i ndihmojnë studentët të përfundojnë me sukses të gjitha hapat deri në mbrojtje të diplomës për programin e studimit Master i Shkencave në “Arkitekturë”. Sipas rregullores së brendshme të FIA komisioni dhe kryetari i komisionit për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës caktohen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohen nga Dekani. (Aneksi nr. 64_Rregullorja e Diplomes)</p> |
| <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> | <p>Referuar RVB, rregullores se programit, si dhe takimeve me stafin akademik, konfirmojmë se përmbyllja e ciklit të dytë studimeve të programit të integruar “Master i Shkencave” në “Arkitekturë”, bëhet me punim diplome: punim i pavarur shkencor i studentit ose projekt arkitektonik, në përputhje me kërkesat e LAL 80/2015.</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p> | <p>Referuar RVB dhe rregullores se FIA-s, rezulton se temat e diplomave dhe udhëheqësit propozohen nga Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe miratohen në Dekanat. Infrastruktura e vënë në dispozicion të studentëve i ndihmon ata për realizimin e testeve apo punëve laboratorike përgjatë ciklit të studimeve. GVJ identifikon mjaft të rëndësishme mundësitë që iu krijojnë studentëve për të kryer matjet, analiza në kuadër të realizimit të punimeve të tyre studimore, shkencore. Është udhëheqësi i punimit të diplomës që përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij, si dhe asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre dhe nxjerrjen e konkluzioneve. Nëse ato janë në përputhje me</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> | <p>Referuar RVB dhe rregullores se FIA-s, rezulton se temat e diplomave dhe udhëheqësit propozohen nga Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe miratohen në Dekanat. Infrastruktura e vënë në dispozicion të studentëve i ndihmon ata për realizimin e testeve apo punëve laboratorike përgjatë ciklit të studimeve. GVJ identifikon mjaft të rëndësishme mundësitë që iu krijojnë studentëve për të kryer matjet, analiza në kuadër të realizimit të punimeve të tyre studimore, shkencore. Është udhëheqësi i punimit të diplomës që përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij, si dhe asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre dhe nxjerrjen e konkluzioneve. Nëse ato janë në përputhje me</p> |
| <p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si</p> | <p>Referuar RVB dhe rregullores se FIA-s, rezulton se temat e diplomave dhe udhëheqësit propozohen nga Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe miratohen në Dekanat. Infrastruktura e vënë në dispozicion të studentëve i ndihmon ata për realizimin e testeve apo punëve laboratorike përgjatë ciklit të studimeve. GVJ identifikon mjaft të rëndësishme mundësitë që iu krijojnë studentëve për të kryer matjet, analiza në kuadër të realizimit të punimeve të tyre studimore, shkencore. Është udhëheqësi i punimit të diplomës që përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij, si dhe asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre dhe nxjerrjen e konkluzioneve. Nëse ato janë në përputhje me</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | rezultatet e pritshme, udhëheqësi jep udhëzimet e nevojshme dhe orienton studentit për zhvillimin e mëtejshëm të diplomës. Referuar dokumentit të procedurës së përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi garanton zhvillimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar, si dhe cilësinë e rezultateve. Vetëm me miratimin e tij studenti mund të dalë për mbrojtje para komisionit të diplomimit. | | | |
| Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Në takimin me stafin akademik, u konstatua se në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë të cilat do të paraqiteshin në procesverbal. Kjo u pohua dhe nga studentët të cilët ishin në dijeni të saj, pasi në periudhën kur u zhvillua vizita në vend e GVJ ende nuk ishte kryer mbrojtja e diplomës. | | | |
| Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Në evidencën “ <i>Formati i Diplomës dhe Suplementi i programit Msc ne Arkitekturë</i> ”, dhe nga informacioni që GVJ mori gjatë takimit me studentët, rezulton se në përfundim të ciklit 5 vjeçar të studimit, UMT do të pajisë studentët me diplomën dhe suplementin e saj të cilat pas përfundimit të procesit të akreditimit, do të miratohen në organet përgjegjëse të ngarkuar nga MASR. | | | |
| Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Studentët përvec diplomës dhe suplementi pajisen dhe me një kopje të programit të studimit ku paraqitet e gjithë ecuria e tyre mësimore gjatë ciklit të studimit. | | | |
| Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen | GVJ konstaton se UMT ruan dokumentacionin e tij në përputhje me aktet ligjore në fuqi (LAL 80/2015, Ligji për arkivat). Referuar statutit të UMT, konfirmuar dhe gjatë vizitës së GVJ në sekretari, si dhe RVB rezulton se dokumentacioni themelor për studentët është: Regjistri themeltar i studentit i cili vërteton regjistrimin e studentit që pajiset me numër matricullimi deri në marrjen e diplomës ose certifikatës; Regjistri i arritjeve akademike të studentit që vërteton rezultatet e studentit gjatë aktivitetit të tij akademik; Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave që vërteton emetimin certifikatave dhe diplomave. Nga takimi me sekretarinë, u konstatua se këto dokumente si dhe procesverbalet e provimeve, ruhen pas diplomimit, në arkivën e institucionit dhe më pas sipas ligjit per arkivat. Të dhënat origjinale të studentit i kthehen atij, ndërsa institucioni ruan kopje të njësuar me origjinalin në formë hardcopy dhe elektronike. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |


| Shkalla e përmbyshjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbyshet | Përmbyshet pjesërisht | Përmbyshet kryesisht | Përmbyshet plotësisht |
|--|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimitor-shkencor dhe administrativ.</p> | <p>Referuar organikës e UMT, listës së stafit akademik në fakultet (tabela e PAE dhe PAK në FIA), listës së personelit akademik për programin e studimit për vitin akademik 2020-2021, janë paraqitur të dhëna për stafin akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi. Program i studimit ka dhe kordinatorin e tij, që është staf akademik i brendshëm. Fakulteti ruan të dhëna për stafin e angazhuar në programet që ofron FIA. Të dhënat përditësohen çdo vit akademik dhe përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të kordinatorit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimitor-shkencor dhe administrativ. Nga takimi me zyrën e burimeve njerëzore rezultoi se listat e pedagogëve përditësohen para fillimit të çdo viti akademik apo semestri dhe në mënyrë të vazhdueshme në varësi të aktiviteti që ka stafi.</p> <p><i>(Aneksi nr. 69 _Të dhëna për mbulimin e lëndëve me personel akademik)</i> <i>(Aneksi nr. 70 _Lista e dokumentave per dosjen e pedagogut)</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se rekrutimi i personelit akademik bëhet në përputhje me bazën ligjore dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Gjatë vizitës në institucion në takimin me zyrën e burimeve njerëzore, GVJ u njoh me realizime konkrete të procedurave të rekrutimit dhe i gjeti ato në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Procesi zhvillohet çdo vit akademik i koordinuar nga fakulteti dhe Rektorati i UMT.</p> <p><i>(Aneksi nr. 29 _Udhëzim mbi Politikat dhe Procedurat e punesimit te PA ne UMT)</i> <i>(Aneksi nr. 01 _Statuti i UMT)</i> <i>(Aneksi nr. 02 _Rregullore UMT)</i></p> |





| | | | | |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> | <p>Referuar RVB dhe takimit me zyrën e BNJ ne UMT, konstatojmë se kriteret dhe procedurat e posaçme për rekrutimin e personelit përcaktohen nga departamentet dhe fakulteti në bazë të nevojave që ai ka për punësimin e stafit akademik të cilat më pas i përcillen zyrës së BNJ e cila bën shpalljen e tyre në faqen zyrtare të UMT.</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p> | <p>Lidhur me procedurat e rekrutimit të stafit akademik të përshkruara në RVB, pas informacioneve të marra dhe nga zyra e BNJ, si dhe takimeve me stafin akademik, rezulton se institucioni ndjek dhe zbaton procedura të sakta rekrutimi për stafin akademik që angazhohen në programin e studimit. Fakulteti dhe universiteti ngre komisione të posaçme ad hoc (5 persona) për vlerësimin dosjeve te aplikanteve. Procedura të standardizuara ndiqen për përzgjedhjen e personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm. Sipas deklarimeve të përfaqësuesve të fakultetit, dhe të zyrës së BNJ në Rektorat, për rinovimin e kontratës merren parasysh vlerësimet gjatë vitit nga departamentet dhe vlerësimi nga studentët.</p> <p><i>(Aneksi nr. 29 _Udhezim mbi Politikat dhe Procedurat e punesimit te PA ne UMT)</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p> | <p>Referuar rregullores se UMT, si dhe takimeve të GVJ, rezulton se insitucioni angazhohet në krijimin e një mjedisi sa më të përshtatshëm pune për stafin akademik. Personeli akademik gjatë takimit me GVJ u shpreh se për realizimin e programit të studimit është vënë në dispozicion infrastruktura e nevojshme në fakultet si dhe infrastruktura e universitetit, përfshirë dhe ambientet laboratorike, duke i dhënë kështu mundësinë e barabartë pësonelit akademik në kryerjen e detyrave dhe funksioneve të tyre.</p> <p><i>(Infrastruktura e Universitetit Metropolitan Tirana, Infrastruktura e didikuar per FLA)</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional</p> | <p>Referuar RVB, takimit me stafin akademik, rezulton se metodat e ndjekuara nga UMT me qëllim kualifikimin e vazhdueshëm dhe</p> |




| | | | | |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | <p>zhvillimin profesional të stafit akademik që mbulon programin e studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesmarrje në aktivitete shkencore të përbashkëta me institucione të huaja dhe vendase; - Ofrimin e leksioneve të hapura me lektorë të huaj; - Ofrimin e trajnimeve lidhur me metodat inovative në projekte specifike; | | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor.</p> | <p>Stafi akademik në takim me GVJ u shpreh se UMT i kushton rendësi të vecantë trajnimit të tyre në përdorimin e teknologjisë në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Kjo u gjet e mbështetur, pasi këto trajnime kryheshin nga pedagogje të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT, pjesë përberëse e UMT-së. Gjithashtu UMT-ja kishte organizuar trajnime për implementimin e sistemeve informatike për përdorimin e platformës të menaxhimit edu4schools, nga kompania që e ofron, si dhe udhëzues lidhur me përdorimin e moduleve që ofron kjo platforme kanë ndikuar në përdorimin më me lehtësi të këtyre shërbimeve që UMT ofron.</p> <p><i>(Manuale përdorimi të Sistemit informatik të studenteve. Platformat për mesimin online)</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të integruar të studimeve</p> | <p>Zyra e burimeve njerëzore disponon listën e personelit akademik të programit të studimit dhe atij mbështetes dhe rezulton se fakulteti disponon burimet e nevojshme njerëzore për realizimin me sukses të programit të studimit. Zhvillimi i profilit didaktik të stafit të fakultetit kryhet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet ofrimit të leksioneve të hapura me lektorë të huaj, ofrimit e trajnimeve lidhur me metodat inovative në fushat përkatëse, programet e mobilitetit në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, pjesmarrje në aktivitete shkencore të përbashkëta, trajnime kualifikuese etj.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

Standardi IV.3



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për</p> | <p>Referuar RVB, kriteri 1 / standardi IV.3, GVB ka paraqitur informacione të detajuara për kapacitetet infrastrukturore që ka fakulteti dhe universiteti. Ky informacion mbështetet dhe me</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

| | |
|--|--|
| <p>zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> | <p>evidencën përkatëse për infrastrukturën. Bazuar në këto gjetje dhe në vizitën e ambjenteve rezulton se mjediset në dispozicion të programit të studimit janë plotësisht të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një mbarëvajtje të procesit mësimor. Sipërfaqja në dispozicion të procesit mësimor në godinat ku zhvillon mësimin Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës është rreth 2714 m², ndërsa janë në dispozicion në nivel universiteti rreth 4800 m². <i>(Aneksi nr. 108 _Asete infrastrukturore akademike – UMT)</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> | <p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se mjediset mësimore ku zhvillohej procesi për realizimin e programit të studimit ishin të pajisura me mjete të tilla si: kompjutera, softëare profesionale, qasje në literaturë, të cilat garantojnë realizimin me sukses të procesit mësimor. UMT ka në dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe verpimtarisë administrative 2 godina:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Godina 1 me 2347 m² – Godina 2 me 2490 m² |
| <p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> | <p>Sipërfaqja në dispozicion të procesit mësimor në godinat ku zhvillon mësimin Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës është rreth 2714 m². Në këto godina gjatë vizitës në vend u panë salla për zhvillimin e leksioneve, salla seminaresh, salla projektimi, gjithashtu laboratore informatike si dhe biblioteka. Nga vizita e ambjenteve që realizoi GVJ, rezulton se mjediset janë të ndriçuara dhe të pajisura me kapacitete ngrohëse e ftohëse. Ambientet e zhvillimit të mësimin janë të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillimin e programit mësimor sipas lëndëve. Sallat e leksioneve janë të pajisura me video projektor dhe ambientet ne te gjitha godinat kanë mundësi për të aksesuar sistemin ëireless të internetit, që mund të nevojitet për zbatimin apo përmirësimin e procesit mësimor dhe jo vetëm.</p> <p><i>(Aneksi nr. 107 _Ambjentet - Infrastruktura e FIA – UMT)</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p> | <p>Bazuar në RVB dhe ne evidencën për infrastrukturën e UMT, rezulton se në dispozicion të studentëve të programit të studimit janë 2 laboratore informatike, gjithashtu studentët e programit të studimit mund të përdorin kompjuterat që ndodhen në ambjentet e bibliotekës së institucionit. Sic rezultoi edhe nga vizita në ambjentet e FIA, ka mbulim me rrjet wi-fi në dispozicion të studentëve. <i>(infrastruktura e FIA-s, infrastruktura e bibliotekës).</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave</p> | <p>Referuar RVB dhe takimit me stafin akademik dhe drejtues të fakultetit, konsatuam se universiteti ka si objektiv strategjik afatmesem ndërtimin e Kampusit të Ri Universitar, me një sipërfaqe mbi 5000 m², i cili është projektuar të ndërtohet në zonën e “Qytetit studentit” zonë pranë ndërtesave aktuale të UMT si edhe pranë institucioneve të tjera publike e provate të arsimit të lartë. UMT me</p> |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike | kapacitetet që zotëron por edhe në bashkëpunim me institucione të tjera garanton mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale. <i>(Aneksi nr. 107_Ambjentet - Infrastruktura e FLA - UMT.)</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |


| Standardi IV.4 | |
|---|---|
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | GVJ realizoi viziten në bibliotekë. Në bibliotekë kryhej dixhitalizimi i skedarëve, si dhe shkembimi i informacionit me biblioteka të tjera brenda dhe jashtë vendit. Personi përgjegjës për bibliotekën evidentonte numrin e frekuentuesve në bibliotekë, frekuencën e përdorimit të titujve, revistave në të cilat botohen artikujt shkencorë të stafit akademik, vizitorët që frekuentojnë bibliotekën dhe citimet e punimeve shkencore të stafit. |
| Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Biblioteka ka në dispozicion të studentëve tekste mësimore të hartuara nga pedagogët e UMT si dhe nga pedagogë të universiteteve të tjera. Fondi i bibliotekës mbulonte fushat e shkencave ekonomike, inxhinierike dhe të arkitektures në gjuhë shqipe dhe të huaj. Në të mundësohej kërkimi i informacionit on-line, në sallën e leximit dhe pranë kompjuterave të sallës. Biblioteka pasurohej në vazhdimësi me me disertacionet e doktoratës të stafit akademik, botimet shkencore, ciklet e leksioneve dhe tekstet mësimore të personelit akademik të institucionit. UMT ofron aplikacionin “edu4school”, ku nëpërmjet këtij aplikacioni studentit i mundësohet qasja në leksione dhe materiale të tjera që janë në përputhje me syllabuset lëndore. Biblioteka e UMT disponon një numër vëllimesh prej 758 tituj librash, si dhe një numër i konsiderueshëm revistash shkencore, cikle leksionesh, botime e artikuj kërkimor dhe shkencor. |
| Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | Referuar RVB dhe takimeve me stafin, rezulton se në marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur, personeli mund të shfrytëzojë edhe bibliotekat dhe infrastrukturën që partnerët disponojnë. Universiteti ka vënë në dispozicion libraritë on line me akses për personelin akademik dhe studentët në të cilat mund të aksesohen |
| Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | |

| | | | | |
|--|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p> | <p>botimet elektronike të disa librarive online. Të gjitha sa më lart, viheshin në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve pa pagesa shtesë. Orari i shfrytëzimit të bibliotekës ishte i përshtatshëm për studentët në përputhje me orarin e tyre të mësimit. Kompjuterat në bibliotekë kanë akses në internet dhe të pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve për projekte, detyra, prezantime etj. Në periudha të veçanta të vitit akademik, biblioteka dispozicion të studentëve në orare të zgjatura.</p> | | | |
| <p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p> | <p>(Aneksi nr. 109 _Relacion per Biblioteken UMT)</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> | <p>Referuar RVB, takimeve në institucion, rezulton se UMT-ja ka në përdorim sistem të ruajtjes dhe përpunimit të informacionit elektronik “edu4school”. Nëpërmjet këtij sistemi ofrohen funksionalitete të nevojshme për sekretarinë mësimore, kërkimin shkencor ku çdo pedagog publikon listën e punimeve shkencore, menaxhimin financiar, etj. Kjo u pohua dhe në takimet me stafin akademik dhe studentët, si dhe gjatë vizitës në sekretari. Sipas deklarimeve të stafit dhe studentëve përdorimi i edu4school, si dhe shërbimet që ofrohen nga kjo platform, shkurtojnë procedurat, rrisin transparencën dhe sigurinë e të dhënave.</p> |
| <p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> | <p>UMT-ja përdor dhe platformën Ualbania të Rrjetit Akademik Shqiptar, ku me anën e moduleve të sistemit të bazës së të dhënave realizohet procesi e aplikimit dhe regjistrimit online të kandidatëve maturanëve në programet e UMT-së. Gjithashtu dhe procesin e matricullimit të studentëve, UMT-ja e realizon nëpërmjet Qendrës së Shërbimeve Arsimore bazuar në të dhënat e detajuara që vë në dispozicion institucioni. Rrjetet sociale, janë një mënyrë tjetër komunikimi që përdor institucioni.</p> |
| <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të</p> | |





| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Githashtu, UMT ka llogari të posaçme dhe përdor shërbimet e ASCAL Management System (AMS) nëpërmjet të cilit nga deklaratimet e kordinatorit institucional, institucioni administron dhe menaxhon të gjithë informacionin elektronik dhe arkivën elektronike që lidhet me të dhënat e institucionit, strukturën akademike, administrative dhe shërbimeve, programet e studimit dhe të dhënat e detajuara për to, studentët aktivë që ndjekin studimet, stafin akademik në kohë reale, fushën e studimit, kualifikimet dhe të dhëna të tjera të cilat përditësohen në kohë reale. | | | |
| Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Nëpërmjet këtij sistemi, UMT-ja aplikon për shërbime të ndryshme të kryera nga ASCAL-i dhe, po ashtu, raporton në mënyrë të vazhdueshme në ASCAL në lidhje me aktivitete të zyrës së sigurimit të cilësisë apo raportime në lidhje me procese të vlerësimit që janë në zhvillim në UMT. UMT –ja ka faqen e vet zyrtare, në gjuhë shqipe dhe gjuhë angleze, nëpërmjet të cilës përcohet informacioni lidhur me verpimtarinë e institucionit për të tjerë. Po nëpërmjet faqes zyrtare, UMT-ja pasqyron veprimtarinë administrative, institucionale, akademike, kulturore e sociale që pasqyrohet në rubrika të veçanta, informacion lidhur me dokumentet kryesore të UMT-së, vendime të Senatit Akademik (miratim kriteresh, kuota, afate aplikimi regjistrimi të studentëve etj.), ciklet dhe programet e studimit, organigramën e UMT-së, njoftime/thirrje për projekte, Revista shkencore, biblioteka etj. Informacionet që lidhen me programin e studimit, planin mësimor, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, që publikohen në faqen e zyrtare të UMT janë në gjuhë shqipe dhe angleze. | | | |
| Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Mënyrë tjetër komunikimi që përdoret në UMT është dhe ajo e rrjeteve sociale (FB) apo komunikimi i brendshëm nëpërmjet postës elektronike me domain të institucionit | | | |
| Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe | <p>.@umt.edu.al, me të cilin është pajisur i gjithë stafi akademik e administrativ, si dhe studentët.</p> <p>Të gjitha metodat e përdorura të ruajtjes dhe shkëmbimit të informacionit, bazuar në RVB dhe ne takimin me IT rezulton se administrohen nga personi përgjegjës i sektorit të teknologjisë dhe informacionit në nivel rektorati si dhe nga drejtorja e komunikimit, të cilët janë njëkohësisht përgjegjës për sigurinë e informacionit dhe ruajtjen e tij.</p> <p><i>(Aneksi nr. 43 _Sistemi informatik i menaxhimit te studenteve)</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 44 _Manuale perdorimi te sistemit informatik te studenteve)</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 45 _Nderfaqja (administratori, pedagogu, sekretaria, studenti)</i></p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: www.ascal.al

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.


| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> | <p>Përsa i përket aktivitetit financiar, GVB ka paraqitur evidencat përkatëse bashkëlidhur, RVB si Raporte vjetore të aktivitetit financiar, plane financiare, të ardhura në FIA në 5 vitet e fundit.</p> <p>UMT-ja harton çdo vit raport mbi ecurinë financiare për cdo program studimi që ofron, si dhe paraqet në të planifikimin e kostove.</p> <p>Në këtë plan u gjetën të detajuara të gjitha zërat e nevojshëm për realizimin e programit të studimit, ku përfshihen mjediset për realizimin e procesit mësimor, materialet dhe pajisjet e nevojshme si si projektore, kompjutera, libra, pajisje laboratorike etj.</p> |
| <p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p> | <p>Në hartimin e buxhetit të UMT, nga takimi me titullarët e fakulteti dhe zyrën e financës, rezulton se merren në konsideratë të ardhurat që gjeneron institucioni nga studentët, grantet nga projektet e fituara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, shërbime për të tretë, granti që jepet nga aksioneri i shoqërisë për projekte të reja zhvillimore të UMT, etj. (<i>Buxheti i UMT-FIA</i>). Hartimi i buxhetit të UMT ndjek një procedurë të mirëpërcaktuar, (<i>RVB dhe takimi me zyrën e financave</i>).</p> <p>Në buxhet, qartazi janë specifikuar zërat e të gjithë shpenzimeve dhe investimeve në përputhje me zhvillimin dhe realizimin me sukses të procesit mësimor, kërkimor dhe administrativ. Është Bordi i Administrimit (organi kolegjal) i cili merr në shqyrtim Planin e Buxhetit Afatmesëm (PBA), pas miratimit nga Senati Akademik. Bordi i Administrimit miraton përfundimisht PBA-në, pasi vlerëson efikasitetin e përdorimit të fondeve financiare në dispozicion dhe rezultatet e pritshme. Njësisia përgjegjëse për monitorimin e aktivitetit dhe treguesve financiarë në Universitetin Metropolitan Tirana, ishte zyra e financës, e cila raporton periodikisht Bordit të Administrimit nëpërmjet raporteve të menaxhimit financiar.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> | <p>Referuar RVB dhe takimeve me titullarët e FIA-s dhe me zyrën e financës rezulton se UMT kryen auditimin e pasqyrave financiare dhe bën vlerësimin e respektimit të standardeve të raportimit financiar nëpërmjet zyrës së auditimit (e licencuar). Informacioni financiar i gjeneruar nga zyra e financës, përdorej për të mbështetur zhvillimin e</p> |

| | | | | |
|---|---|--|--|--|
| <p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> | <p>programit dhe analizën e kostos, si dhe për të siguruar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë financiare. Referuar RVB dhe takime në institucion, rezulton se kapacitetet e menaxhimit financiar të UMT mbështeten në një linjë me proceset dhe dokumenteve që UMT mban të tilla si: aplikimi i praktikave kontabël në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat janë të shprehura qartë dhe të vlefshme për Bordin e Administrimit dhe personelin drejtues; monitorimi i buxhetit në baza faktike dhe / ose krahasuese për të arritur një perceptim më të mirë të financave; përgatitjen e parashikimeve të fluksit së parasë dhe parashikimin e të ardhurave të fundvitit, shpenzimet dhe kostot e studentëve për të ndihmuar në marrjen e vendimeve të shëndosha të menaxhimit gjatë vitit. Në fund të çdo viti akademik, në UMT kryhej analiza e kostos së të gjitha programeve të studimeve (takimi me zyrën e financës). Analiza e kostos përmban: Shpenzimet operacionale: koston e mësimdhënies, pagat e stafin mbështetës administrativ si dhe shpenzimet e tjera operacionale si qeraja, energjia elektrike / telefon / interneti etj që lidhen me këto programe; Shpenzimet kapitale (Investime): kostoja e asetëve të blera për drejtimin e programeve akademike si kompjuterët dhe pajisjet IT, labororet e programeve inxhinierike, mobiljet dhe asetet e tjera, si dhe kostoja e aktiveve të patrupëzuara si blerja e licencave për programet softuerike, tarifat e akreditimit, bibliotekat elektronike. Analiza e kostos së programeve shqyrtohet në raport me të ardhurat e gjeneruara nga programet. Analiza e fitimit / humbjes kryhet për secilin program dhe nëse është e nevojshme modifikimet e duhura të komponentëve të caktuar të kostos bëhen për vitin e ardhshëm akademik. Në përfundim GVJ vlerëson se UMT ka të gjitha mjetet e nevojshme financiare për realizimin me sukses të procesit mësimor.</p> <p><i>(Aneksi nr. 118 _Shpenzimet dhe të ardhurat UMT në 3 vitet e fundit)</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 128 _Buxheti i UMT-FIA (procedurat e hartimit dhe miratimit për 2020)</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 129 _Auditimi financiar i UMT)</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p> | | | | |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| Standardi V.1 | |
|---|---|
| Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Referuar Statutit dhe Rregullores së UMT, si dhe gjithë akteve rregullative specifike të tij, rezulton se institucioni ka procedura të cilat mbulojnë ciklin e plotë të një studenti që nga regjistrimi për herë të parë në programin e studimit deri në diplomimin e tij. Pranimi i studentëve për çdo vit akademik kryhej në përputhje me kuotat dhe kriteret e miratuara për çdo program studimi të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit. Kriteret specifike të pranimit dhe numri i kuotave në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Arkitekturë” përcaktohen nga Departamenti i arkitekturës dhe urbanistikës dhe miratohen nga Dekanati i FIA. Në planifikimin e kuotave të pranimit për vit akademik, merren në konsideratë kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të UMT. Referuar faqes zyrtare të UMT, rezulton se i gjithë informacioni i mësipërm, bëhet publik në webin e UMT dhe në rrjetet sociale të universitetit. |
| Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejtën e njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Universiteti nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek, garanton barazinë dhe të drejtën për të gjithë kandidatët për studentë. Prej vitesh, UMT nëpërmjet komisioneve ad-hoc të përbëra me përfaqësues nga çdo fakultet dhe sistemeve informatike që përdor, ka zhvilluar procedurat më të drejta të përzgjedhjes së studentëve që regjistrohen në ciklin e parë të studimeve dhe në ciklin e dytë. |
| Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë i rëndësishëm të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Në rregulloren e sekretarisë mësimore dhe takimin që GVJ realizoi në sekretarinë mësimore, rezulton se regjistrimi i studentëve, ecuria përgjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë të sanksionuara në aktet e institucionit. Procedurat janë të miratuara e të bëra publike në faqen e UMT-së. |
| Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e integruar të studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | Studentët deklarojnë se informohen në fillim të çdo viti akademik. Në takimin me dekanin e fakultetit, dhe studentët rezultojnë se Drejtoria e Komunikimit në bashkëpunim me Fakultetin dhe Këshillin Studentor organizojnë aktivitete informuese për maturantët e shkollave jo vetëm të Tiranës por edhe të retheve të tjera, në këto aktivitete behet një prezantim i programit të studimit si dhe i ambjenteve të fakultetit, maturantët kanë mundësinë të |
| Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | |
| Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të | |

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| pakicave dhe shtresave të marginalizuara. | kalojnë një ditë në amjentet e shkollës për ty njohur me FIA-n. Informacion i plotë informues paraqitet edhe ne Guidën e studentit | | | |
| Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | UMT ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta të studentëve, si komuniteti rom dhe egjiptian, studentët me aftësi të kufizuara apo studentët me të ardhura të pakta ekonomike, duke parashikuar kuota pranimi në programet e studimit sipas kategorive të veçanta, si dhe duke ofruar bursa studimi. Për secilën kategori janë paracaktuar kriteret për përfitimin e bursave deri në masën 100%. Krahas programit të bursave për kategori të ndryshme, për studentët aktivë ofrohen internshipe dhe punësim pranë institucionit ose partnerëve të tij. | | | |
| Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë | Referuar RVB dhe takimeve me dekanin dhe stafin akademik rezulton se UM ka krijuar inkubator in Campus, i cili operon prej 3 vitesh tashmë, duke inkubuar idetë më të mira dhe duke ofruar trajnime dhe ekspertizë nëpërmjet organizimeve të bootcampeve me qëllim orientimin e studentëve drejt punësimit. (Aneksi nr. 01_Statuti i UMT); (Aneksi nr. 02_Rregullore UMT); (Aneksi nr. 79_Guida e studentit UMT); (Aneksi nr. 80_Shembull_Java e orientimit UMT-FIA.); (Aneksi nr. 87_Dosje studenti te regjistruar_shembull.) | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|--|
| Standardi V.2 | |
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program. | |
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Nga takimi me studentët, u pohua pre tyre se informohen periodikisht nga institucioni. Gjithashtu, informacion të shpejtë studentët e merrnin nëpërmjet organizimit të studentëve në këshilla studentorë, lidhur me procesin mesimor apo procedura të tjera. Në evidencën (Aneksi nr. 30_Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit te programeve UMT)..si dhe nga bashkëbisedimi me studentët rezulton se UMT ka të përcaktura qartë procedurat dhe kriteret për studentët të cilët duan te transferojnë studimet e tyre në UMT apo për ata studentë të cilët kanë kualifikime të pjesshme. |
| Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | |


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> | <p>Studentët informoheshin për arritjet e tyre gjatë vitit akademik, kriteret hyrëse në provimin e lëndës nëpërmjet sistemit të menaxhimit edu4school. Përveç të dhënave / rezultateve të provimeve që ruhen në sekretarinë mësimore, personeli akademik raportonte në mënyrë periodike mbi ecurinë e studentëve në lëndët/modulet që ai zhvillon.</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p> | <p>Nga takimi me studentët, rezulton se instrumente të tjera informimi në kohë reale ishte faqja zyrtare e UMT-së, faqet zyrtare të pedagogëve, rrjetet sociale, komunikimi nëpërmjet adresave elektronike të pedagogëve, ku ata informohen mbi orarin mësimor, njoftimet mbi aktivitete, workshop-et apo konferencat, oraret e pritjeve nga pedagogët, informimi për syllabuset etj. Gjatë vizitës në institucion u evidentua se UMT vinte ne disponon dhe mjete të komunikimit të brendshëm, si njoftimet në monitorët brenda UMT, si dhe afishimet e posterave.</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p> | <p>Referuar përdorimit masiv të rrjeteve sociale (FB), si forme komunikimi e cila ka rezultuar e suksesshme, dhe po përdorej nga UMT-ja gjerësisht edhe për njoftimet zyrtare të fakultetit. Studentët informohen mbi programin e studimit edhe me anë të rrjeteve sociale të UMT, Guida e studentit si dhe me anë të faqes zyrtare të UMT. Gjithashtu bazuar në <i>(Aneksi nr. 104 Aktivitete e kryera nga studentet-qeveri studentore)</i>, UMT-FIA.FIA dhe UMT mbështet këshillin studentor në organizimin e takimeve informuese për maturanët të cilët duan të bëhen pjesë e programit të studimit. Përfaqësues të fakultetit organizojnë takime me maturantë për promovimin e programeve të studimit që fakulteti ofron.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

| | |
|--|---|
| <p>Standardi V.3</p> | |
| <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi</p> |
| <p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> | <p>Programi i studimit, plani mësimor dhe rregullorja e tij u vihen në dispozicion studentëve të rinj në javën e parë në institucion. Referuar rregullores se programit të studimit dhe takimit me studentët informohen se programi i studimi ofrohet në 5 vite akademik ku studentët në përfundim të ciklit 5 vjeçar duhet të grumbullojnë 300 kredite ECTS. Studentët në fillim të cdo viti</p> |


| | | | | |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| | <p>akademik marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me kohezgjatjen e programit të studimit, mënyrën e vlerësimit të njohurive, planin mësimor, si dhe literaturën që do i duhet të shqyrtojnë për çdo lëndë e cila është e parashikuar në syllabus.</p> <p><i>(Aneksi nr. 53 _Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit)</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 54 _Plani mësimor)</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 79 _Guida e studentit UMT)</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> | <p>Në evidencat e paraqitura për programin e studimit dhe nga takimi e studentet, rezultojnë se ata njihen me informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit, informacionin e përgjithshëm, planin mësimor e deri më në hollësi me përmbajtjen e lëndëve nëpërmjet syllabuseve të tyre, dhe me stafin akademik.</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p> | <p>Nga takimi me studentët si dhe referuar RVB rezultojnë se studentët informohen për çdo aspekt për të cilin ata janë të interesuar si p.sh. mbi mundësitë e mobilitetit nëpërmjet programeve të ndryshme, punësimin si dhe mbështetjen institucionale për orientimin në tregun e punës. Orientimi dhe këshillimi i studentëve, përveç zyrës së karrierës dhe shërbimit të studentit, realizohet dhe nëpërmjet guidave informative, materiale të cilat janë të publikuara në formë dixhitale, në dispozicion të studentëve si Guida e Studentit.</p> <p><i>(Aneksi nr. 43 _Sistemi informatik i menaxhimit të studenteve)</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 79 _Guida e studentit UMT)</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>Referuar takimit me studentët, rezultojnë se studentët janë të informuar mbi infrastrukturën e fakultetit dhe ambientet ku do të realizohet procesi mësimor. Nëpërmjet gjithë sistemit të menaxhimit në UMT studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Gjatë takimit me studentët ata pohuan disponimin e këtij informacioni dhe lehtësitë e qasjen në të.</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p> | <p>Informacione merret përmes Kordinatorit të programit, sekretarisë mësimore, grupeve në rrjetet sociale, faqes së internetit.</p> <p>Sistemi i menaxhimit edu4school u mundëson studentëve informimin mbi ecurinë e programit të studimit, notat e provimeve, frekuentimin, komunikimin me pedagogët, si dhe me sekretarinë mësimore. Ky sistem nga sa u informua GVJ nga takimi me studentët, mund të përdoret edhe jashtë ambienteve të FIA-s, pasi çdo student është i pajisur me kredencialet përkatëse. <i>(Aneksi nr. 43 _Sistemi informatik i menaxhimit të studenteve)</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p> | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |

| | | | | |
|--|--|--|--|---|
| | | | | X |
|--|--|--|--|---|

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit. | Referuar te dhënave statistikore mbi numrin e studentëve, rregullores se UMT, si dhe takimit ne sekretarinë mësimore, rezulton se FIA disponon statistika mbi numrin e studentëve dhe ecurinë e tyre, institucionet nga vijnë nëse janë të transferuar, mesataren në hyrje dhe në dalje të tyre si dhe numrin e studentëve të diplomuar. Në statistikat e vëna në dispozicion të GVJ, është kryer edhe analiza mbi cilësinë e studentëve në hyrje dhe ecuria e tyre gjatë studimeve. GVJ iu vunë në dispozicion regjistrat themeltarë që gjendeshin tek sekretaria mësimore. Këto regjistra përmbanin të gjitha të dhënat që kërkohen ligjërisht dhe aty evidentohet qartë numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. |
| Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e integruar të studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | |
| Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre. | Nga takimi që GVJ realizoi me sekretarinë mësimore evidentoi se sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbarevajtjen e të dhënave të ecurisë së studentëve në programin e studimit, me anë të regjistrave të notave dhe të frekuentimit, regjistrat të gjeneraliteteve, dosjeve të studentëve. Dosjet e studentëve ruhen në sekretarinë mësimore. GVJ konstatoi që të gjitha të dhënat disponohen nga institucioni dhe përdoren prej tij si bazë të dhënash. <i>(Aneksi nr. 95_Rregullore e sekretarise UMT)</i> |
| Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Referuar RVB dhe takimit me studentët GVJ, u konfirmua se ata përdorin sistemin edu4school i cili i shërben ndër të tjera edhe për administrimin, menaxhimin dhe ruajtjen e konfidencialitetit të studentëve. Studentët u shprehën të kënaqur me sistemin e menaxhimit. Referuar <i>(Aneksi nr. 62_Numri i studenteve te regjistruar per here te pare ne FIA - ne 5 vite)</i> , numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është: |

| | Viti akademik | Nr i studentëve të regjistruar për herë të parë | Studentë të transferuar ndër vite | |
|--|---------------|---|-----------------------------------|--|
| | 2017 -2018 | 14 | 2 | |
| | 2018-2019 | 12 | 3 | |
| | 2019-2020 | 6 | 2 | |
| | 2020-2021 | 24 | 6 | |
| | | 56 | 13 | |
| | Totali | 69 | | |


| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve | Referuar RVB dhe te dhënave tabelore bashkëlidhur RVB, rezulton se UMT bën analiza dhe raporte mbi ecurinë e studentëve si dhe i njeh ata me mundësitë e punësimit, sic rezultoi dhe nga takimet që GVJ realizoi ne institucion. Zyra e Këshillimit të Karrierës, ALUMNI dhe Shërbimit ndaj Studentit, informon lidhur me shkallën e punësimit të studentëve sipas programeve të studimit. Drejtorja e komunikimit dhe marrëdhënieve me jashtë, është njësia që analizon punësimin e studentëve të diplomuar sipas programeve të studimit. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi V.5 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | Bazuar në statutin dhe rregulloren e UMT rezulton se studentët përfaqësohen në organet kolegjiale të universitetit, siç janë Senati Akademik, Këshilli studentor, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe komisionet had-hoc të ngritura në kuadër të vlerësimeve dhe analizave në nivel institucional dhe programi. Pjesë e grupit të vlerësimit të këtij programi ka qënë gjithashtu një përfaqësues i studentëve (përbërja e GVB). <i>(Aneksi nr. 01 _Statuti i UMT); (Aneksi nr. 02 _Rregullore UMT)</i> |
| Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në | Në takimi me studentët dhe shqyritmi DVV, evidencave lidhur me organizimin studentor në UMT; si dhe vendimeve të organeve kolegjiale për përfshirjen e studentëve ne to, rezulton se studentët |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | |
|--|--|
| <p>vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p> | <p>janë pjese aktive dhe e rëndësishme e organeve përfaqësuese dhe administrative të UMT. Në UMT, funksionon Këshilli studentor i UMT (KS UMT), i cili është organ kolegjal, me përfaqësues të zgjedhur nga vetë studentët. KS. Sic u konfirmua dhe nga takimi me studentët ata gjejnë mbështetje të vazhdueshme nga stafi akademik dhe administrative për sa i përket ecurisë dhe ngarkesës mësimore që ata kanë.</p> <p>Në mënyrë periodike, KS në bashkëpunim me fakultetin dhe struktura të tjera të UMT, kryen aktivitete në vit, duke nisur nga Konferencat Kombëtare ku studentët marrin pjesë në mënyrë aktive duke punuar tema shkencore dhe eksperimentale nën udhëheqjen e profesorëve, pjesëmarrje në Shkollat Verore e Dimërore apo trajnimet me tematika të ndryshme brenda e jashtë vendit (aktivitete studentore). Studentët japin mendime për cilësinë e mësimdhënies dhe të programit të studimit si dhe lidhur me çështje të ndryshme, si tarifata e studentëve, kurrikulat e programeve, projektet kërkimore shkencore, praktikat, sezonet e provimeve etj. Një rast konkret i reflektimit të mendimit të studentëve është mënyra e realizimit të praktikave profesionale me studentë (diskutime me studentë)</p> <p><i>(Aneksi nr. 09_Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Aneksi nr. 12_Aktet per perfshirjen e studenteve ne organet kolegjiale te UMT)</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton që institucioni është i hapur ndaj sugjerimeve të studentëve për përmirësimin e programit të studimit. Tërheqja e mendimeve bëhet nga departamenti/fakulteti/NJSBC, si gjatë diskutimit të planeve mësimore në fazat e miratimit të tyre ashtu dhe në fund të semestrit kur analizohen aftësitë dhe kompetencat e marra gjatë lëndës. Në dokumentet rregullative në nivel universiteti, fakulteti dhe specifikisht në rregulloren e programit të studimit është parashikuar procesi i transferimit të studimeve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për këtë aspekt. <i>(Aneksi nr. 58_Rregullore e programit)</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p> | <p>Vetë fakti që studentët janë pjese e NJSBC dhe përfshihen nga FIA edhe në grupet e punës për hartimin e raporteve të vlerësimit të jashtëm sic konkretisht kanë vepruar në hartimin e RVB, konfirmon faktin se institucioni i angazhon dhe i bën pjesë studentët në rishikimet dhe përmirësimet e programit të studimit</p> |
| <p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të</p> | <p>Bazuar në takimin me studentët dhe takimin me sekretarinë mësimore, dosjen e programit, rregulloren e programit si dhe në evidencën <i>model pyetësori për studentët</i>, rezultojnë se studentëve i jepet mundësia dhe i garantohet e drejta për të dhënë mendimi dhe vlerësimin e tyre mbi metodat e mësimdhënies, kontrollin e dijeve,</p> |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | gjithashtu në rast pakënaqësish ata kanë të drejtë të ankimojnë rezultatin e marrë pranë njësisë përgjegjëse të cilat më pas ngrënë një komision ad hoc për rivlerësimin e rezultatit të studentëve. <i>(raporti i vlerësimit të brendshme, raporte analitike të vlerësimit kryer nga NJSBC)</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.6

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. | Referuar DVV dhe takimit me stafin akademik rezulton se personeli angazhohet dhe merr pjesë në konferenca, workshope dhe kongrese. GVJ vlerëson impaktin e kërkimit shkencor dhe kontributin që jep FIA në zhvillimin e arkitekturës dhe ndërtimit në Shqipëri. Personeli akademik është i angazhuar në pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete kombëtare. Këto aktivitete pasqyrohen në analizën vjetore të fakultetit që bëhet periodikisht. <i>(EV-73-Raport vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar – UMT); (EV-93-Raporti mbi aktivitetin Kërkimor-Shkencor të stafit akademik - FIA.)</i> |
| Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. | FIA-UMT në funksion të programit të studimit ka lidhur një sërë marrëveshjesh ndër të cilat janë edhe ato me institucione të tjera të arsimit të lartë. Të gjitha këto marrëveshje i mundësojnë FIA-s shkëmbimin e eksperiencës së stafit akademik dhe mundësinë e pjesëmarrjes në projekte të ndryshme. Bazuar në numrin e madh të bashkëpunimeve, GVJ vlerëson pozitivisht përpjekjet e institucionit për të bashkëpunuar me organizma dhe institucione brenda dhe jashtë vendit në kuadër të rritjes së bashkëpunimit dhe mobilitetit. <i>(EV-22-Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimit në rrjete)</i> |
| Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe të publikojnë studime e punime shkencore. | Referuar RVB, evidencave të paraqitura lidhur me aktivitete e zhvilluar nga studentë, si dhe takimet me studentet, rezulton se studentët mbështeten, nxiten dhe motivohen nga stafi akademik për të publikuar apo referuar punët e tyre kërkimore apo shkencore. |
| Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore | |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|--|
| ndërkombëtare të punimeve kërkimore-shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve. | Studentët janë motivuar të marrin pjesë me publikime në aktivitete shkencore të FIA-s (nga takimi me studentet) | | | |
| Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave. | Sa i përket stafit akademik nga takimi me dekanin e FIA dhe personelin akademik, GVJ u informua se personeli akademik mbështet në infrastrukturën didaktike të FIA për punimet e tyre kërkimore shkencore dhe më pas publikimin në revista me factor impakti. Konstatimi i përfshirjes së studentëve në kërkim shkencor pohuar kjo në takimin me student, vlerësohet pozitivisht nga ana e GVJ. <i>(Tabela 19 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit)</i> | | | |
| Kriteri 6. Personeli akademik mbështet studentët në kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës | GVJ konstatoi se udhëheqësi i temës i nxiti studentët të fokusohen në analizimin dhe dokumentimin e rezultateve duke u bazuar në provën eksperimentale dhe statistikore. Studentët inkurajohen të përdorin dhe aplikojnë metoda dhe metodologji inovative të cilat do tju jepnin mundësi atyre të jenë më afër realitetit dhe nismave bashkëkohore të kërkimit shkencor dhe të përdorimit të teknologjive të inovacionit. <i>(Evidenca 59 Modeli i diplomës; Evidenca 91 Lista e Studentëve tema e diplomes udhëheqes 2020-2021.)</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht X |

| | |
|---|--|
| Standardi V.7 | |
| Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor. | |
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë kombëtarë me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit | Nga marrëveshjet në kuadër të mobilitetit dhe bashkëpunimit të stafit për kërkim shkencor, është mundësuar ngritja e kapaciteteve profesionale dhe kërkimore të personelit akademik dhe fakultetit në tërësi. Nga takimi me pedagogët, rezultoi se një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë zhvilluar vizita studimore, në institucione partnere (raporti i kërkimit), duke përfituar nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe projektet. <i>(EV-25-Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për stafin akademik ne kuader te erasmus+)</i> <i>(EV-26-Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për studentët ne kuader te erasmus +)</i> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|--|
| | <i>(EV-27-Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të shkëmbimitmobilitetit.)</i> |
| Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve. | Referuar RVB si dhe takimit me stafin dhe studentet rezultojn se bashkëpunimet kanë sjellë përmirësim të vazhdueshëm të përmbajtjes së programit të studimit i cili me përmbajtjen aktuale përputhet me mjaft programe që zhvillohet në institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Zbatimi i këtyre metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve në fushën e arkitekturës. <i>(Evidenca 54 Plani mësimor); (Evidenca 56 Plan programet e lëndëvesyllabuset)</i> |
| Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj vendës dhe të huaj në projekte kërkimore. | Referuar RVB dhe takimeve me stafin akademik, Dekanin si dhe me zyrën e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë të UMT, u informua se, politikat e kërkimit të institucionit janë konceptuar, për të qënë gjithëpërfshirëse dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen e studiuesve të rinj (strategjia e zhvillimit). Kjo formë bashkëpunimi ka favorizuar angazhimin e personelit të ri në aktivitete kërkimore si dhe rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në studime, dhe në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare. Nga evidencat rezultojn se ne vijimësi janë ftuar lektorë të huaj të cilët zhvillojnë takime dhe leksione të hapura në FIA. |
| Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj. | <i>(EV-25-Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për stafin akademik në kuader të erasmus+)</i> |
| Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare. | Nga RVB dhe nga shqyrtimi i evidencave për programin e studimit, rezultojn se kurrikula e programit të integruar të studimit është konceptuar dhe ndërtuar me synimin për të përgatitur studentë me kompetenca dhe aftësi për tu adaptuar në tregun e punës po aq sa edhe për të qënë pjesë e studimeve të mëtejshme. Në programin e studimit janë përfshirë lëndë me karakter formues, analitik dhe profesional. Kjo u krijon atyre mundësinë të kenë njohuri të duhura në dimensione të ndryshme profesionale por edhe të kenë aftësi për të përdorur metoda dhe teknika të reja që zbatohen aktualisht në institucionet partnere. Vetë studentët janë aktivë dhe përfshihen në veprimtari ndërkombëtare (Guida e studentëve, aktiviteti kërkimor, aktivitete me student). |
| Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore | Referuar evidencës e paraqitur lidhur me pedagoget e ftuar të huaj si dhe takimeve me studentet, rezultojn se UMT fton në vijimësi figura në fushën e arkitekturës për të organizuar leksione të hapura apo seminare me studentët. <i>(Evidenca 54 Plani mësimor); (EV-72-Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve- UMT)</i> |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p> | <p>Referuar statutit dhe rregullore dhe organigramës së UMT rezultojnë se institucioni disponon strukturat e nevojshme informuese për studentët siç janë, Sekretaria mësimore, Zyra e këshillimit të karrierës dhe Alumnit. Kjo zyrë mirëpret, informon dhe orienton studentët në lidhje me aspekte të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Nga ana tjetër kjo zyrë merr përsipër të njoftojë dhe ndjekë studentët në lidhje me aktivitete me karakter shkencor apo trajnimi për adaptimin e njohurive të tyre. Zyra siguron mundësi të ndryshme trajnimi, mobiliteti, projektesh dhe bashkëpunon ngushtë me këshillat studentorë. Të dhënat e gjeneruara ndihmojnë studentët për punësim dhe fakultetit të mbajë kontakte të vazhdueshme dhe të ndjekë historikun e punësimin të studentëve.</p> <p><i>(EV-1-Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana); (EV-2-Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.)</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> | <p>Në takimet e zhvilluar me administratën e Rektoratit, rezultojnë se funksionon një zyrë e posaçme për informimin e studentëve dhe publikun në tërësi. Informacioni i nevojshëm publikohet në disa forma: format letër, në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, procedurave, etj., të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor,</p> | <p>Nga takimi me sekretarinë dhe me studentet rezultojnë se sekretaria mësimore është një njësi ku studenti mund të marrë një seri shërbimesh, informohet në lidhje me ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi.</p> <p>Zyra e këshillimit të karrierës në UMT është po ashtu një strukturë që ofron shërbimin e këshillimit dhe karrierës, ku studentët mund të marrin informacion në lidhje me trajnimet,</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> | <p>praktikat apo ofertat e punësimit. Procedurat për informimin dhe transparencën në informim janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse, kjo pohuar nga takimi me studentet.</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p> | <p>Referuar RVB dhe takimeve me zyrën e karrierës dhe studentet, rezulton se kjo zyrë informon dhe orienton studentët në lidhje me aspekte të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës, njofton në lidhje me aktivitetet me karakter shkencor apo trajnimi për përditësimin e njohurive të tyre. Zyra siguron mundësi të ndryshme trajnimi, mobiliteti, projektsh dhe bashkëpunon ngushtë me këshillat studentorë. Zyra e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Për shkak se programi i studimit ende nuk ka të diplomuarit e parë, ky informacion do të plotësohet në vijimësi.</p> <p><i>(EV-50-Rregullore e FIA); (EV-77-Rregullore e Zyres së Këshillimit të Karrieres)</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |


VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË STUDIMIT

| | |
|---|--|
| <p>Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e</p> | <p>Referuar statutit të UMT, në zbatim të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë në Shqipëri, UMT ka ngritur me Vendim të Senatit Akademik, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila përbëhet nga shtatë anëtarë nga të cilët një është student dhe një ekspert i</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al






| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> | <p>jashtëm. Kjo strukturë është përgjegjëse për respektimin e standardeve të cilësisë në gjithë programet e studimit të UMT dhe cilësinë në universitet. Ajo monitoron dhe garanton realizimin e proceseve të ndryshme akademike në UMT.</p> <p><i>(EV-7-VSA për ngritjen e Njësise së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë)</i> <i>(EV-8-Përbërja e NjSBC);(EV-9-Rregullore e NJSBC)</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> | <p>Referuar rregullores së NJSBC, takimeve me këtë strukturë dhe me titullarët e njësive kryesore FIA, rezulton se Njësia e Sigurimi të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për respektimin e standardeve të cilësisë, organizon dhe bashkëpunon me fakultetet dhe departamentet për vlerësimin periodik të programeve mësimore, cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor. Pyetësori për studentët, si dhe vlerësimi i stafit akademik që realizohet çdo fund semestri, janë instrumente të cilat përdoren nga NJSBC për sigurimin e cilësisë.</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p> | <p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë në UMT, referuar RVB dhe akteve rregullative të UMT vënë në dispozicion, rezulton se mbështetet në statutin e UMT, Politikat e Cilësisë të UMT, në rregulloren përkatëse të NJSBC. Sigurimi i jashtëm i cilësisë monitorohet nga ASCAL, nëpërmjet të cilës ndiqen procedurat për vlerësimin e jashtëm të cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucionit dhe të programeve që ai ofron. Vlen të theksohet si një element pozitiv që program i integruar i studimit MSc Arkitekturë e ka nisur tashme procesin e akreditimit dhe ky është akreditimi i parë i këtij programi studimi. Ndërkohe që institucionalisht UMT është i akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit nr.45 dt.21.09.2017 për një afat 5 vjeçar.</p> <p><i>(EV-9-Rregullore e NJSBC); (EV-13-Vendimi për Akreditimin Institucional të UMT nga Bordi i Akreditimit dhe Certifikata e akreditimit.)</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p> | <p>Në DVV, si dhe në evidencat lidhur me raportet vjetore të veprimtarisë së UMT apo të analizave të pyetësorëve të studentëve dhe stafit akademik, rezulton se NJSBC vlerëson performancën e stafit akademik, gjendjen dhe cilësinë e infrastrukturave e pajisjeve, funksionimin e zyrave mbështetëse, financimin e qëndrueshëm të programeve të studimit, ngarkesën e stafit. Raportet e hartuara në rang fakulteti, garantojnë përfshirjen e gjithë njësive përbërëse dhe aktorëve të brendshëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>(EV-9-Rregullore e NJSBC); (EV-73-Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar –UMT)</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|--|--|--|--|----------|
| | | | | X |
|--|--|--|--|----------|

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë. | Referuar Statutit dhe organigramës të UMT-së, rezultojnë se institucioni ka njësi të cilat angazhohen në ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit siç janë NJSBC, Zyra e Kurrikulës. Njësia përgjegjëse për programin e studimit është departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, i cili jo vetëm organizon aktivitetin e këtij programi, por menaxhon edhe punën për realizimin sa më cilësor të tij. <i>(Aneksi nr. 01 _Statuti i UMT); (Aneksi nr. 04 _Organigrama UMT)</i> |
| Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë. | Referuar dokumentit të paraqitur në DVV, si dhe nga takimi me titullarët e FIA-s, rezultojnë se institucioni përdor procedura formale e të dokumentuara për shqyrtimin dhe miratimin e programeve të studimit. Procedura fillon me propozimin e departamentit, pas shqyrtimit dhe miratimit në Dekanat i përcillet nëpërmjet dekanit në Senatën e UMT për miratim. <i>(Aneksi nr. 41 _Procedura për hapjen e një programi të ri studimi apo ndryshimi-rishikimi i një programi ekzistues në UMT)</i> |
| Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. | Referuar RVB dhe takimit me studentët dhe NJSBC, rezultojnë se instrumentet e përdorur për vlerësimin e cilësisë përfshijnë anketimet dhe pyetësorët për studentët që plotësohen në fund të çdo semestri, formularin e vlerësimit të performancës së stafit akademik, inspektimet gjatë zhvillimit të procesit mësimor, vlerësimin e detyrave/ projekteve dhe provimeve të studentëve dhe kontrollin e plotësimin të ngarkesës mësimore dhe akademike. <i>(Aneksi nr. 58 _Rregullore e programit); (Aneksi nr. 10 _Analize e NJSBC për pyetësoret e stafit akademik); (Aneksi nr. 11 _Model i pyetësorit për studentet)</i> |
| Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Referuar evidencave si dhe takimit me NJSBC, rezultojnë se të gjitha rezultatet e mbledhura gjatë vitit akademik në kuadër të programit të studimit, janë pjesë e analizave vjetore të njësive bazë dhe kryesore të UMT. Të gjitha gjetjet në procedurat dhe |

Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë

metodologjitë për sigurimin e cilësisë u përcillen autoriteteve vendimarrëse për programin e studimit (departamentit)si dhe organeve kolegiale të cilët mbështetur në aktet ligjore e nënligjore marrin masat përkatëse.

Në raportin vjetor në nivel universiteti, NJSBC, si strukturë përgjegjëse, analizon dhe vlerëson përputhshmërinë e programit të studimit me standardet shtetërore të cilësisë për programet dhe për institucionin. Ky raport është subjekt i diskutimeve në mbledhjen e organeve kolegiale të UMT si Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, ku evidentohet plani i masave me strukturat përgjegjëse dhe afatet e realizimit. Është NJSBC e cila ka detyrimin e monitorimit të realizimit të planit të masave (konfirmuar në takimin me NJSBC).

(Aneksi nr. 73_Raport vjetor i aktivitetit mesimor, kerkimor dhe financiar – UMT);

(Aneksi nr. 71_Model i formularit te vleresimit te Performances);

(Aneksi nr. 93_Raport mbi aktivitetin kerkimor-shkencor te stafit akademik FIA);

(Aneksi nr. 115_Procesverbal i kontrollit ne auditore); (Aneksi nr. 119_Vendim senati per Vleresimin e Vazhduar UMT);


| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | |

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | GVJ konfirmon se programi i integruar i studimit Msc ne Arkitekture i nënshtrohet për here të parë vlerësimit në kuadër të akreditimit, në përputhje me kërkesat ligjore. GVJ konstaton se vlerësime për cilësinë e ofrimit të tij janë kryer në mënyrë të vazhdueshme nga FIA, që në aktivizimin e programit për herë të parë në vitin akademik 2017-2018, referuar dhe raporteve vjetore te UMT. Nga shqyrtimi i Raporteve vjetore, rezulton se NJSBC përfshin rezultate të vlerësimit nga raportet vjetore të njëjësive kryesore dhe të institucionit, si dhe nga raporte |
| Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e | |

| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | të vlerësimit të brendshëm institucional apo programesh të kryer në kuadër të akreditimit. | | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> | <p>GVJ konstaton se rishikimi periodik i programit dhe përditësimet e tij në elementët tij, janë pjesë e procesit të përmirësimit të vazhdueshëm të tij prej vitesh. Metodatat e vlerësimit të cilësisë bazohen në mekanizma kryesore të matjes në bazë të cilave kryhet vlerësimi i cilësisë të programit të studimit. Këto metoda na u konfirmuan dhe nga titullarët e fakultetit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - -Monitorimi nga NJSBC në nivel institucional; - -Monitorim i vazhduar nga koordinatori i programit të studimit; Vlerësime nga komisione ad-hoc të ngritura nga Dekani i fakultetit në bashkëpunim me NJSBC; - Realizim sondazhesh, anketimesh dhe mbledhje informacionesh nga studentët; - Monitorime nga drejtuesit e departamentit; | | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p> | <p>Referuar RVB, takimeve me stafin akademik dhe me studentë, GVJ konstaton se takimet periodike me studentët dhe me këshillin studentor që realizohen nga Dekani i fakultetit, problematikat që ngrihen nga ana e studentëve në këto takime, janë pikënisja e një procesi të caktuar monitorimi /vlerësimi. Tregues i cilësisë së programit të studimit është dhe se si ai u shërben studentëve pas diplomimit, në punësimin e tyre. Zyra e Karrierës dhe UMT në vijimësi mban kontakte me ALUMNI UMT Aktualisht nuk ka të diplomuar në këtë program studimi. <i>(Rrjeti Alumni UMT)</i></p> <p>Tregues tjetër i cilësisë së programit, të cilin GVJ e vlerëson pozitivisht, është performanca e studentëve në nivel ndërkombëtar, si në aspektin profesional ashtu dhe në atë akademik. Referuar RVB dhe takimeve me studentët, u konfirmua se në aspektin profesional, studentët e diplomuar në programet e UMT, kanë marrë të drejtën e ushtrimit të profesionit në shume vende të tjera, ndërsa në aspektin akademik, studentë të diplomuar nga FIA kanë ndjekur ose ndjekin studime master apo phd në vende të ndryshme të Evropës. U konstatuan projekte bashkëpunimi të UMT me universitet te huaja, të iniciuara nga studentë ALUMNI të institucionit.</p> <p><i>(Aneksi nr. 02_Rregullore UMT); (Aneksi nr. 10_Analize e NJSBC per pyetesoret e stafit akademik); (Aneksi nr. 11_Model i pyetesorit per studentet.); (Aneksi nr. 50_Rregullore e FIA); (Aneksi nr. 71_Model i formularit te vleresimit te Performances);</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |


Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Referuar RVB, rregullores së UMT, rregullores së NJSBC dhe evidencës ku jepet përbërja e NJSBC, rezulton se nga 7 anëtare të kësaj strukture, një prej tyre është ekspert i jashtëm, në këto kushte GVJ vlerëson se institucioni ka përfshirë aktorë të jashtëm në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit. GVJ identifikoi se institucioni garanton nëpërmjet politikave dhe procedurave e brendshme, përfshirjen e stafit, studentëve dhe partnerëve me të cilët institucioni bashkëpunon, bazuar dhe në kuadrin ligjor dhe marrëveshjet e bashkëpunimeve të vëna në dispozicion.</p> <p><i>(Aneksi nr. 02_Rregullore UMT); (Aneksi nr. 09_Rregullore e NJSBC); (Aneksi nr. 50_Rregullore e FIA);</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> | <p>Bazuar në rregulloren e NJSBC dhe përbërjen e saj, rezulton se kryetari, anëtarët, studenti dhe eksperti i jashtëm, kanë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Bazuar në takimin e zhvilluar me përfaqësues të njësive përkatëse, studentët dhe personelin akademik, rezulton se ndiqen veprimtaritë që lidhen me evidentimin e problematikave, vlerësimin periodike të cilësisë, marrjen e masave në kuadër të përmirësimit, marrja e mendimit të studentëve, vlerësim të performancës së stafit, përshtatje të metodologjive të ndryshme dhe zbatimi i eksperiencave ndërkombëtare në FIA-s etj.</p> <p><i>(Aneksi nr. 03_Plani Strategjik i Zhvillimit UMT); (Aneksi nr. 09_Rregullore e NJSBC)</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Referuar RVB ku thuhet: <i>“Të gjitha nivelet e strukturave përbërëse të UMT janë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë të programeve të studimit dhe institucionit..”</i>, takimeve me NJSBC, në mekanizmat e sigurimit të cilësisë dhe akteve rregullatore që ka UMT, rezulton se sigurohet gjithëpërfshirja e kontribuuesve në procesin e mësimdhënies dhe aspekteve të tjera akademike. Bazuar në Rregulloren e UMT dhe të Fakultetit, rezulton se janë të përcaktuara qartë rolet por dhe përgjegjësitë e çdo njësie/strukture dhe individit të angazhuar në ofrimin e programit të studimit dhe garantimin e cilësisë së tij.</p> |
| <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset</p> | |


| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> | <p>GVJ konstaton se stafi akademik dhe studentët përfshihen në procese të ndryshme të cilësisë (nga takimet me stafin dhe me studentët). Në gjykimin e GVJ, lidhur me përfshirjen e stafit dhe studentëve, mundëson transparencë dhe informim për proceset që kryhen në kuadër të cilësisë.</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p> | <p>Personeli akademik i UMT, referuar dhe njohjeve personale si kolegë, rezulton se një pjesë e tyre ka eksperiencë si ekspertë vlerësimi. Referuar marrëveshjeve që UMT ka me institucione të tjera të arsimit të lartë dhe takimit që GVJ realizoi me Dekanin dhe NJSBC, rezulton se çdo procedurë që kryhet kalon nëpërmjet njoftimit paraprak dhe me pas kalon në proces zhvillimi. Në këto procese vazhdimisht përfshihen bashkëpunëtorë, partnerë të FIA-s dhe/ose ose të UMT dhe studentë të diplomuar, të cilët ndihen pjesë integrale e çdo procesi me rëndësi në fakultet.</p> <p><i>(Aneksi nr. 02_Rregullore UMT); (Aneksi nr. 03_Plani Strategjik i Zhvillimit UMT); (Aneksi nr. 09_Rregullore e NJSBC)</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

| | |
|--|---|
| <p>Standardi VI.5</p> | |
| <p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi</p> |
| <p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> | <p>Nga takimi që GVJ realizoi me studentët dhe nga kqyrja e platformës edu4shcool, faqes së internetit të universitetit, rezulton se, dokumentet që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë në UMT janë bërë publike. Studentët, stafi akademik dhe të gjithë të interesuarit mund të kenë akses në këtë dokumentacion dhe mund të marrin informacionin e duhur mbi proceset e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> | <p>Referuar Kodit të Etikës dhe rregullores së Drejtorisë së Komunikimit, rezulton se UMT tregon kujdes në publikimin e informacioneve apo të dhënave personale që mund të prekin stafin akademik dhe administrativ apo studentët. Gjatë takimit me NJSBC dhe Zyrën e kurikulave, GVJ u informua për të gjitha procedurat që ndiqen nga këto zyra për sigurimin e cilësisë. I gjithë aktiviteti i këtyre zyrave realizohej mbi bazën e një plani periodik, në hartimin e të cilit</p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> | <p>merren në konsideratë të gjitha problemet e evidentuara nga aktiviteti i mëparshëm me synim përmisimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>GVJ identifikoi se rezultatet e vlerësimeve, raportet dhe analizat publikohen, duke respektuar lirinë akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p> | <p>Për informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve mbi sigurimin dhe përmisimin e programit të studimit, NJSBC organizon takime me strukturat e rektoratit dhe fakultetit. Studentët kanë përfaqësuesin e vet edhe tek NJSBC dhe GVB, gjë cka ju mundëson atyre që të përcjellin në mënyrë të vazhdueshme mendimet e tyre mbi problemet e cilësisë.</p> <p>Referuar Raporteve vjetore të UMT dhe planit të zhvillimit strategjik, rezulton se FIA adreson në planin vjetor të punës gjetjet dhe dobësitë e nxjera nga vlerësimit e brendshme të programit të studimit të cilat duhen përmirësuar.</p> <p><i>(Aneksi nr. 07_VSA per ngritjen e NJSBC dhe perberja e NJSBC); Aneksi nr. 09_Rregullore e NJSBC);</i> <i>Aneksi nr. 14_Rregullore e Etikes UMT);</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |




Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science" in Architecture with profiles: a. Architect; b. Bio-Architect; c. Architect-Restorer; ç. Architect-Engineer; d. Architect-Interior"

a. Strengths and affirmations

1. The academic staff is highly qualified. It's also alternated between domestic staff and abroad staff;
2. Relatively high number of institutional agreements;
3. Participation on several international projects and staff exchanges, ensuring the academic development of the study program;
4. The quality ensurance mechanisms functions in effective and moderate way;
5. The study scholarships for this study program are motivating and supportive, so incouraging the requests from the qualitative students, proved by the encrease of quality of students in amissions and by their results;
6. The plan program is well structured and competitive;
7. The relations between the faculty members and the students are very positive and motivating;

b. Weak points

1. Low number of literature in hard copy for the study program;
2. Low number of the implementing projects in the field would also help the development of scientific research in the future;

Recommendation

1. Continuous improvement of literature in hard copy for the study program;
2. As per actual plan of the institution, adding the number of the implementing projects in the field would also help the development of scientific research in the future;

Shkalla e përmbushjes së standarteve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |

| | | | | |
|---|--|--|--|----------|
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

